




Projekti "Margina Obscura"
është përkrahur nga Bashkimi Evropian



HALLKA që mungon

Demistifikimi i të drejtave
të personave me handicap në
Republikën e Maqedonisë me
vështrim mbi të drejtën në arsim

Polio Plus
Lëvizje kundër handicapit





ПОЛИО ПЛУС
движење против
хендикеп



Agency for Cooperation, Education and Development

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të
personave me handicap në
Republikën e Maqedonisë me
vështrim mbi të drejtën në arsim

Publikimi “Hallka që mungon” - demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim është përpiluar në kuadër të projektit: Margina Obscura – çështja e handicap në aderimin drejt Bashkimit Evropian. Qëllimi kryesor i projektit është që ta përforcojë ndikimin e sektorit qytetar nëpërmjet Zërit të vetëm të Organizatave të personave me handicap gjatë krijimit të politikave publike, miratimit të vendimeve dhe përforcimit të dialogut qytetar dhe politik.

Publikimi është përgatitur me përkrahje financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Polio Plus dhe, në asnjë mënyrë, nuk i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian



Mendimet që janë shprehur këtu u takojnë autorëve dhe nuk i pasqyrojnë qëndrimet e Polio Plus

Publikimi mund të riprodhohet për dedikime edukative, në çfarëdo mënyre, pa pagesë. Gjatë kopjimit për qëllime tjera, për përdorim në publikime tjera ose për përkthim dhe adaptim duhet të sigurohet leje paraprake nga botuesit

Publikimi është në dispozicion në formë elektronike në www.polio plus.org.mk



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

PËRMBAJTJA

“HALLKA QË MUNGON” - DEMISTIFIKIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME HANDIKAP NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË ME VËSHTRIM MBI TË DREJTËN NË ARSIM

Botues

Polio Plus – lëvizje kundër handicapit

Për Botuesin

Zvonko Shavreski

Përkthimi, Lektura

Oz dizajn

Shtyp

HONOR PEÇAT

Dizajni dhe përpunimi tekniko-grafik

Ognjen Fidanoski

Tirazhi 1000 ekzemplarë

Viti 2018

IP – Katalogjizimi në publikim

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare “Shën Kliment Ohridski”, Shkup

343.733-056.26/.36:340.13(497.7)(047.31)

ISBN 978-608-4608-27-1

© Polio Plus – lëvizje kundër handicapit

Hyrje 7

KREU I

STANDARDET NDËRKOMBËTARE JURIDIKE 10

1. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Handikap e OKB 12

2. KEDNjLTh – Protokolli 12 i KEDNjLTh dhe Karta Evropiane Sociale 15

3. Pikëpamjet përfundimtare të Raportit inicial të Republikës së Maqedonisë nga Komiteti mbi të Drejtat e Personave me Handikap 16

KREU II

KORNIZA JURIDIKE KOMBËTARE 26

1. Legjislacioni i vendit dhe harmonizimi i tij me KDPH 27

2. Statistika dhe të dhëna në nivel kombëtar 32

3. Perceptimi për diskriminimin në bazë të aftësive të kufizuara 44

KREU III

DEMISTIFIKIMI I ÇËSHTJES SË AFTËSISË SË KUFIZUAR NË REALIZIMIN E SË DREJTËS NË ARSIM 48

1. Objektivi, lënda dhe shembulli i hulumtimit 49

2. Analiza kuantitative dhe kualitative e përgjigjeve të pyetësorëve 53

Konkluzione dhe rekomandime 76

Bibliografia 83

HYRJE

Дали лицата со хендикеп во остварувањето на правото на образование ги уживаат истите права на еднаква основа со другите?



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

HYRJE

Polio Plus - Lëvizje kundër Aftësive të Kufizuara, në kuadër të projektit “Margin obscura”, të financuar nga Bashkimi Evropian, ka përpiluar analizën me titull “Hallka që mungon” - demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim.

Njohja e nevojës për përfshirjen e personave me handikap, si çelës për realizimin e të drejtës për arsimim është nxitur veçanërisht në 30 vitet e fundit dhe e njëjta është inkorporuar në Konventën mbi të Drejtat e Personave me Handikap (në tekstin e mëtejme: KDPH).

Analiza synon të grumbullojë informacione dhe për të parë se çfarë mendimi ka komuniteti me handikap në ushtrimin e së drejtës për arsimim, nëse ata i gëzojnë këto të drejta në baza të barabarta me të tjerët, si dhe për t'i interpretuar të njëjtat në dritën e detyrimeve të shtetit në zbatimin e KDPH -së në kontekstin kombëtar. Për këto arsye, sfida ishte që, në një vend, të shqyrtohet

gjendja e personave me handikap në ushtrimin e kësaj të drejte në përgjithësi dhe specifikat që i rregullon KDPH-ja, si në karakterin material, ashtu edhe në atë teknik.

Publikimi është përpiluar duke aplikuar metodologji të kombinuar, e cila përbëhet: nga shqyrtimi i literaturës dhe dokumenteve, analizës së 1000 pyetësorëve të marra nga personat me handikap dhe prindërve të fëmijëve me handikap, grupet e fokusit dhe intervistat gjysmë të strukturuar.

Për më tepër, ky publikim sqaron kuptimin, fushëveprimin, si dhe pyetjet e hapura dhe diskutimet rreth KDPH-së, si dhe i prezanton pikëpamjet e Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Handikap pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara (në tekstin e mëtejme: OKB) në mënyrë që të nxirren konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e gjendjes.





HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në arsim

HYRJE

Analiza përbëhet prej katër kapitujve:

- **Kapitulli I** - jep pasqyrë për të drejtën e arsimimit për personat me handicap në përputhje me standardet ndërkombëtare, me theks të KDPH, duke shpjeguar procesin dhe përmbajtjen, duke përfshirë edhe interpretimin e kuptimit dhe përfshirjen e kësaj të drejte.
- **Kapitulli II** – e analizon situatën në mënyrë indikative në nivel kombëtar nga aspekti i harmonizimit të kornizës legjislative me KDPH, si dhe të dhënat në dispozicion në nivel kombëtar dhe lokal. Në të njëjtin janë përfshirë edhe pikëpamjet dhe raportet ekzistuese në këtë sferë.
- **Kapitulli III** – e analizon gjendjen në terren rreth asaj se si është perceptimi i komunitetit me handicap, sa i përket ushtrimit të së drejtave në sferën e arsimit.
- **Kapitulli IV** – i përmbledhë të gjitha konkluzionet nga kapitujt e mëparshëm dhe jep rekomandime që kanë të bëjnë me hapat që shte-

ti duhet të ndërmarrë për të harmonizuar legjislacionin dhe për të ndryshuar praktikën në lidhje me ushtrimin e së drejtës për arsim.

Ky publikim duhet të shërbejë si mjet për përpilimin e programeve, masave dhe politikave sistemore për ndryshimin e ndërgjegjes kolektive mbi këtë çështje, si dhe për të kontribuar në harmonizimin e kornizës legjislative me KDPH-në.

KREU I

STANDARDET NDËRKOMBËTARE JURIDIKE



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU I

Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Personave me Handikap dhe Protokollin Fakultativ i saj u miratuan me konsensus në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (në tekstin e mëtejme OKB) në mbledhjen e saj të 61-të, të mbajtur më 13 dhjetor të vitit 2006, me Rezolutën A/RES/61/106¹. Aktualisht, 162 shtete e kanë nënshkruar Konventën, ndërsa 177 shtete janë palë kontraktuese. Ndërsa, nga ana tjetër, 92 shtete e kanë nënshkruar Protokollin fakultativ dhe 92 shtete e kanë ratifikuar të njëjtën².

KDPH është përgjigje nga bashkësia ndërkombëtare e historisë së gjatë të diskriminimit, përjashtimit dhe dehumanizimit të personave me handikap. Ajo thekson se pakica më e madhe në botë duhet t'i gëzojë të njëjtat të drejta dhe mundësi, sikurse të gjithë të tjerët. Ajo mbulon shumë fusha në të cilat diskriminohen personat me handikap,


përfshirë qasjen në drejtësi, pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike, arsimin, punësimin, ndalimin e torturës, shfrytëzimin dhe dhunën, si dhe lirinë e lëvizjes. Duke iu qasur ratifikimit të Protokollit Opsional, individë ose shtetet anëtare që kanë ngritur padi për të drejtat e tyre dhe kanë shteruar mjetet juridike vendore mund të kërkojnë përgjigje të përsëritur nga një organ ndërkombëtar i pavarur.

Republika e Maqedonisë e ka nënshkruar KDPH më 30 mars të vitit 2007, ndërsa të njëjtën e ka ratifikuar më 5 dhjetor të vitit 2011. Për më tepër, shteti e ka nënshkruar Protokollin Fakultativ të Konventës më 29 korrik të vitit 2009 dhe e ka ratifikuar më 5 dhjetor të vitit 2011³. Instrumentet për ratifikim janë deponuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara më 29 dhjetor të vitit 2011.

¹[Shih: Rezoluta është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 13 Dhjetor të vitit 2006, 24 janar të vitit 2007. Në dispozicion në: <https://treaties.un.org/doc/source/docs/A_RES_61_106-E.pdf >]

²[Kjo situatë është prej nëntorit të vitit 2018. Për më shumë informacione për statusin e nënshkrimit dhe ratifikimit të KDPH mund të merren në: <http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-15&chapter=4&lang=en>]

³[Shih: Ligji për ratifikimin e Konventës për të drejtat e personave me invaliditet dhe Protokollin fakultativ të Konventës për të drejtat e personave me invaliditet, Kuvendi i RM-së, viti 2011, faqe 19, mund të merret në: <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/ED1FF6FC1C8A1F4A8F36F48EFDE95E55.pdf>>]



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU I

Sipas nenit 118 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë⁴, dispozitat e KDPH-së zbatohen direkt në legjislacion, duke përfshirë edhe gjykatat kombëtare, të cilat, me kalimin e kohës, duhet të mundësojnë krijimin e një praktike të qëndrueshme gjyqësore.

1. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Handikap e OKB

Në të drejtën ndërkombëtare personat me handicap njihen si bartës të së drejtave, ku shtetet kanë detyrimin të njohin të drejtën për arsimim për personat me handicap pa diskriminim edhe në bazë të mundësive të barabarta në të gjitha nivelet, duke përfshirë të mësuarit e përjetshëm.

KDPH-ja është instrumenti i parë ligjërish i detyrueshëm që përmban udhëzime dhe i referohet konceptit për arsim cilësor, inkluziv për personat me

handikap. Në të njëjtën frymë të KDPH-së është edhe Objektivi 4 nga “Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm deri më 2030”, të cilat e konfirmojnë vlerën e arsimit inkluziv, cilësor dhe të barabartë⁵.

Arsimi inkluziv ka rëndësi thelbësore për arritjen e arsimit të cilësisë së lartë për të gjithë nxënësit, duke përfshirë nxënësit me handicap. Edhe në raportin e Zyrës së Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të OKB-së⁶ u theksua se “vetëm arsimi inkluziv mund të sigurojë arsim cilësor dhe zhvillim social për personat me handicap dhe garanci për universalitetin dhe mosdiskriminimin në të drejtën për arsim”.

Neni 24 i KDPH-së, i referohet të drejtës së arsimit inkluziv të personave me handicap në të gjitha nivelet (fillor, të mesëm, të lartë, duke përfshirë edhe mësimin e përjetshëm) dhe në të gjitha sferat (shtetërore dhe private) të procesit

⁴[Shih: Publikimi: “Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, me amendamentet e kushtetutës I – XXXII“, NP Gazeta Zyrtare e RM-së, faqe 55, edicioni 55, në dispozicion në: <<http://www.slvnik.com.mk/content/Ustav%20na%20RM%20-%20makedonski%20-%20FINALLEN%202011.pdf>>]

⁵[Shih: “Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm deri më 2030”, gjendet në: <<https://www.un.org/sustainabledevelopment/education/>>]

⁶[Shih: “Studim tematik për të drejtën e personave me handicap në arsimim. Raporti i Zyrës së Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të OKB, A/HRC/25/29 and Corr.1, paragrafi 3 dhe 68. Në dispozicion në: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session25/Documents/A-HRC-25-29_en.doc>]

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU I

arsimor, pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta.

Për t’u realizuar neni 24 (1) (a), arsimi doemos duhet të fokusohet në zhvillimin e tërësishëm të potencialit njerëzor dhe ndjenjës së dinjitetit dhe vetërespektit, si dhe të shpie në drejtim të përfundimit të respektimit të të drejtave të njeriut dhe promovimit të diversitetit shoqëror. Elemente bartëse në këtë neni janë: parimi i mosdiskriminimit dhe përshtatjes adekuate, që kanë për qëllim realizimin e mjedisit jetësor që do të garantojë praninë, pjesëmarrjen dhe zhvillimin e personave me handicap⁷, ku përkrahja individuale dhe përshtatja adekuate duhet të jenë pa pagesë dhe të arritshme në çdo nivel të sistemit arsimor⁸.

Në mënyrë plotësuese, intenca e nenit 24 është të sigurojë të drejtën e fëmijëve me handicap të zgjedhin lirshëm se në çfarë institucioni do të arsimohen, respektivisht në sistemin e rregullt arsimor


apo në sistemin e arsimit special. Dhe, në këtë drejtim, Komiteti për të Drejtat e Personave me Handikap përcakton se: “vendosja e nxënësve me handicap në klasat e rregullta, pa ndryshime adekuate strukturore, për shembull: në organizatë, program mësimor dhe aplikimin e strategjive të mësimdhënies, nuk është inkluzion. Vetë integrimi automatikisht nuk garanton kalimin nga segregimi në përfshirje”⁹.

Prandaj, neni 24 (2) (c) udhëzon në atë që shtetet doemos duhet të sigurojnë përshtatje të logjikshme që do t’u mundësojë nxënësve me handicap të kenë qasje në arsim në bazë të njëjtë me të tjerët. Për më tepër, vetë procesi arsimor duhet të bazohet dhe t’i shfrytëzojë format alternative të komunikimit siç është shkrimi Braj, gjuha e shenjave, shkathtësitë alternative për shkrim dhe ngjashëm, si dhe mënyrat dhe mjetet që do të maksimalizojnë zhvillimin e tyre

⁷[Shih: “Koment i përgjithshëm nr. 13 (1999), Neni 13: E drejta e arsimit” – neni 13 (2) E drejta e arsimit, faqe 3 OKB Komiteti për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore. Në dispozicion në: <<http://www.refworld.org/docid/4538838c22.html>>]

⁸[Shih: “Koment i përgjithshëm nr. 4 (2016), Neni 24: E drejta e arsimit inkluziv” – paragrafi 17 OKB Komiteti për të drejtat e personave me handicap, në dispozicion në: <<http://www.refworld.org/docid/57c977e34.html>>]

⁹[Shih: “Koment i përgjithshëm nr. 4 (2016), Neni 24: E drejta e arsimit inkluziv” – paragrafi 11 OKB Komiteti për personat me handicap. Në dispozicion në: <<http://www.refworld.org/docid/57c977e34.html>>]



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU I

akademik dhe social. Ashtu që, në rast të personave me dëmtim në të dëgjuarit dhe pengesa në të folurit, gjuha e shenjave duhet të njihet si gjuhë që fëmijët duhet të kenë qasje, ndaj edhe rëndësia e saj duhet të njihet në mjedisin shoqëror¹⁰.

E drejta për arsim të personave me handicap nuk do të zbatohet plotësisht nëse nuk ekziston detyrimi i shteteve që të marrin masa për punësimin e stafit mësimor, duke përfshirë mësuesit me handicap, të cilët janë të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/shkrimin Braj dhe të sigurojnë trajnim për kuadrin mësimor që punon në të gjitha nivelet e arsimit. Ky trajnim do të përfshinte ngritjen e vetëdijes për çështjen e aftësisë së kufizuar dhe përdorimin e mënyrave alternative, pajisjeve dhe formave të komunikimit, materialeve arsimore dhe teknikave për mbështetjen e personave me handicap (Neni 24 (4)).

Sidomos e drejta për arsimim deklaracion se "... programet mësimore në shumë shtete sot pranojnë se personat me hand-

ikap është më mirë të arsimohen në sistemin e rregullt arsimor. ... shtetet duhet të sigurojnë që personeli mësimor të trajnohet në ofrimin e arsimit për fëmijët me handicap në shkollat e zakonshme dhe të sigurojë qasjen dhe pajisjen dhe mbështetjen e nevojshme në mënyrë që personat me handicap të arrijnë të njëjtin nivel të arsimit si të tjerët". Politikat që e rregullojnë këtë institut duhet të miratohen në nivel kombëtar, lokal dhe në të gjitha nivelet e infrastrukturës arsimore. Justifikimi se shteti ka "mungesa të burimeve dhe krizë financiare ekonomike" për të justifikuar "mosndërmarrjen e aksionit", në thelb, paraqet shkelje të nenit 24¹¹.

Për realizimin e të drejtave të personave me handicap, si dhe zbatimin efektiv të KDPH, është e rëndësishme përfshirja aktive e organizatave të personave me handicap, individët me handicap, fëmijët me handicap, ku gjatë kësaj duhet pasur kujdes në përfaqësimin e të gjitha formave të aftësisë së kufizuar, si dhe balancën gjinore.

¹⁰[Shih: "Koment i përgjithshëm nr. 5 (1994), Persona me handicap, paragrafi 35, faqe 8-9, OKB Komiteti për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Në dispozicion: <<http://www.refworld.org/docid/4538838f0.html>>]

¹¹[Shih: "Koment i përgjithshëm nr. 4 (2016), Neni 24: E drejta e arsimit inkluziv" – paragrafi 28, OKB Komiteti për të drejtat e personave me handicap. Në dispozicion: <<http://www.refworld.org/docid/57c977e34.html>>]

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU I

Në realizimin e së drejtës për arsimimin e fëmijëve me handicap nuk duhet përjashtuar fëmijët me handicap që jetojnë në institucione¹². Duhet të përfundohet, në drejtimin e qëndrimit të Komitetit se arsimit inkluziv është jokampitibël me institucionalizimin¹³.

2 KEDNjLTh – Protokoli 12 i KED-NjLTh dhe Karta Evropiane Sociale

Në nivel rajonal, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore është dokument ligjërishit detyrues për të gjitha shtetet evropiane që e kanë ratifikuar, dhe janë pajtuar të sigurojnë kushtet për realizimin e të drejtave themelore të njeriut në kuadër të sistemit të tyre kombëtar. Ato shtete janë të detyruar të zbatojnë KDPH në mënyrë që drejtësia e vendit do t'i proklamojë të drejtat e garantuara nga

ajo Konventë dhe me protokollet shtesë të tyre dhe të sigurojë mbrojtje juridike për secilin individ në nivel kombëtar.

Në kuadër të Këshillit të Evropës është miratuar edhe Karta Sociale Evropiane, në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale. Duke marrë parasysh rastet gjyqësore (rasti Mental Disability Advocacy Center v. Bulgaria dhe rasti Autism-Europe) mbrojtja që e ofron Kara e rishikuar, veçanërisht në fushën e mosdiskriminimit, përmes mundësisë së parashtrimit të ankesave kolektive është mjet i rëndësishëm në luftën kundër formave institucionale të diskriminimi, duke u thirrur në vlerat kryesore, siç është dinjiteti njerëzor dhe përfshirja sociale të personave me handicap¹⁴.

¹²[Shih: Poposka Zh. Publikimi, "Interpretues i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Handikap i Organizatës të Kombeve të Bashkuara", faqe 69-70, 2018 Polio Plus, Në dispozicion: <<http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/Tolkuvac-B5-mk.pdf>>]

¹³[Shih: "Koment i përgjithshëm nr. 4 (2016), Neni 24: E drejta e arsimit inkluziv" – paragrafi 66, OKB Komiteti mbi të drejtat e personave me handicap. Në dispozicion: <<http://www.refworld.org/docid/57c977e34.html>>]

¹⁴[Dr. Poposka Zh, Dr. Jovevski L. Publikimi: "E drejta antidiskriminuese", OSBE në Shkup, faqe 57.]



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU I

Pikëpamjet përfundimtare të Raportit inicial të Republikës së Maqedonisë nga Komiteti mbi të Drejtat e Personave me Handikap

Në vitin 2018, në Sesionin e 20-të të OKB-së, në Komitetin për të Drejtat e Personave me Handikap u vlerësua zbatimi i Konventës për të Drejtat e Personave me Handikap në Republikën e Maqedonisë. Në sesionin dyditor, u vlerësuan të drejtat civile dhe politike, si dhe të drejtat ekonomike dhe sociale për qytetarët me handicap, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Handikap. Në pikëpamjet përfundimtare të Raportit inicial të Republikës së Maqedonisë¹⁵, Komiteti për të Drejtat e Personave me Handikap përcakton disa rekomandime për ushtrimin e së drejtës për arsim (neni 24) i KDPH-së. Përveç rekomandimeve dhe vërejtjeve në nenin

¹⁵[Shih: Pikëpamjet përfundimtare të raportit inicial të Republikës së Maqedonisë nga Komiteti për të drejtat e personave me handicap, të miratuara nga Komiteti në mbledhjen e 20-të (27 gusht-21 shtator 2018). OKB Komiteti për të drejtat e personave me handicap. Në dispozicion në: < https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Doenload.aspx?symbolno=CRPD/C/MKD/CO/1&Lang=En >]

24, në këtë pjesë do të shqyrtojmë edhe një pjesë të disa vërejtjeve dhe rekomandimeve të Komitetit, që janë të lidhura ngushtë me realizimin e së drejtës për arsim.

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU I

Arsimimi (neni 24)

Vërejtje	Rekomandime
<p>Komiteti është i shqetësuar se Ligji për mbrojtjen e fëmijëve dhe Ligji për arsimin fillor ende lejojnë segregimin e nxënësve me handicap dhe ende ka ambiente të segreguara arsimore, veçanërisht për nxënësit me handicap intelektuale.</p> <p>Më tej, Komiteti është i shqetësuar se nuk ka një strategji gjithëpërfshirëse për një sistem arsimor inkluziv, me afate dhe rezultate fikse, si dhe as burime të përshtatshme financiare, njerëzore dhe teknike, veçanërisht për nxënësit me handicap intelektuale. (paragrafi 39).</p>	<p>Në përputhje me komentin e përgjithshëm të Komitetit nr. 4 (i vitit 2016) mbi të drejtën për arsim inkluziv dhe objektivat 4.5 dhe 4.8 të “Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm”, Komiteti i rekomandon Shtetit (paragrafi 40):</p> <p>(a) Të rishikohet Ligji për mbrojtjen e fëmijëve dhe Ligji për arsimin fillor, pasi ato do të kishin promovuar arsimin inkluziv dhe të njëjtat do të inkorporojnë bazën e aftësive të kufizuara në klauzolën mbrojtëse për mbrojtjen nga diskriminimi, duke përfshirë ndalimin e refuzimit të përshtatjes së arsyeshme, si një formë e diskriminimit sipas bazës së aftësive të kufizuara;</p> <p>(b) Të miratohet një plan tranzicioni me qëllim që të sigurohet arsimi inkluziv për personat me handicap në të gjitha nivelet në sistemin arsimor, përfshirë këtu edhe institucionet e arsimit të lartë;</p> <p>(c) Të sigurohet mbështetje adekuate, burime dhe trajnime të kualifikuara për mësuesit dhe personelin ndihmës për të përsheptuar inkluzionin, veçanërisht për nxënësit me handicap intelektuale dhe psiko-sociale, si dhe për vajzat me handicap;</p> <p>(ç) Të sigurohet qasje deri në hapësira arsimore, duke përfshirë edhe universitetet;</p> <p>(d) Menjëherë dhe në mënyrë eksplicite të ndalohet përjashtimi i nxënësve me handicap nga shkollat e rregullta në bazë të aftësive të kufizuara të tyre</p>



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në arsim

KREU I

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në arsim

KREU I

Obligimet dhe parimet e përgjithshme (nenet 1-4)		kornizë kohore ose fonde buxhetore për të siguruar realizimin progresiv të të drejtave të personave me handicap në konsultim me organizatat e personave me handicap.	(ç) Të sigurohet se organizatat e personave me handicap janë të përfshira në mënyrë aktive në krijimin dhe vlerësimin e ligjeve, politikave, planeve të veprimit, kornizave kohore dhe në buxhete, dhe se mendimet e tyre do të merren në konsideratë, para miratimit të vendimeve që kanë të bëjnë me ato.
Vërejtje	Rekomandime		
<p>Komiteti është i shqetësuar për (paragrafi 5) :</p> <p>(a) Mungesën e harmonizimit të legjislacionit, politikave dhe programeve nacional me Konventën dhe përfaqësimin e qasjes mjekësore ndaj çështjes së aftësive të kufizuara;</p> <p>(b) Vlerësimet e ndryshme për përcaktimin e gjendjes së aftësive të kufizuara dhe definicioneve ekzistuese në legjislacion, që nuk janë në përputhje me qasjen e të drejtave të njeriut ndaj çështjes së aftësive të kufizuara.</p> <p>(c) Mungesës dhe planet e paqarta, si dhe rreth asaj se nuk ka</p>	<p>Komiteti i rekomandon shtetit (paragrafi 6):</p> <p>(a) Nevojitet revizion i tërësishëm i legjislacionit dhe politikave ekzistuese dhe harmonizim i tyre i plotë me Konventën;</p> <p>(b) Duhet të mënjahen termet fyese që kanë të bëjnë me çështjen e aftësive të kufizuara dhe të ofrohet respekt ndaj dinjitetit të të gjithë personave me handicap;</p> <p>(c) Të sigurohet metodë për vlerësimin e gjendjes së aftësive të kufizuara që tërësisht e përfshinë qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut, përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfshirjes së organizatave të personave me handicap në krijimin e vlerësimit për kategorizimin e personave me handicap; • Përfshirjen dhe angazhimin e personave me handicap në krijimin e informacionit në bazë të të cilit janë kryer vlerësimet; • Eliminimit të një sërë vlerësimesh dhe kategorizimesh, me qëllim që të mënjahen barrierat e panevojshme; • Informacionit për kushtet si dhe kërkesat për vlerësim të jenë të arritshme dhe në forma të disponueshme; • Kryerjes së revizione të shpeshta të metodave për vlerësimin e kategorizimit të personave me handicap. 		
Barazia dhe mosdiskriminimi (neni 5)			
Vërejtje	Rekomandime		
<p>Komiteti (paragrafi 7) është si shqetësuar se:</p> <p>(a) Neni 9 i Kushtetutës së shtetit nuk e përmban bazën e aftësive të kufizuara për mbrojtje nga diskriminimi;</p> <p>(b) Nuk ekzistojnë dënime/ndëshkime në ligjet nacionale për institucionet publike dhe private apo individë që kryejnë diskriminim ndaj personave me handicap</p>	<p>Komiteti (paragrafi 8) i rekomandon shtetit:</p> <p>(a) Rishikimin e tërë legjislacionit, duke përfshirë bazën e aftësive të kufizuara në mbrojtjen nga diskriminimi, duke përfshirë mbrojtjen nga diskriminimi në baza të ndryshme dhe diskriminimin intersektorial;</p> <p>(b) Aplikimi i masave/mjete juridike me qëllim që të sigurohet dëmshpërblimi, duke përfshirë edhe kompensimin për personat që janë ballafaquar me diskriminim mbi bazën e aftësive të kufizuara dhe aplikimin e masave për ndëshkimin e fajtorëve;</p>		



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

KREU I

KREU I

dhe nuk ka mjete juridike ligjore kundër diskriminimit bazuar në aftësitë e kufizuara;

(c) Nuk janë siguruar trajnime të rregullta për mosdiskriminim dhe përshtatje të arsyeshme për aktorët publik dhe privatë.

(c) Aplikimi i trajnimeve të rregullta të aktorëve publikë dhe privatë për mosdiskriminim dhe përshtatjen e arsyeshme për personat me pengesa të bazuar në të drejtat e njeriut e jo në qasjen tradicionale mjekësore dhe të mëshirës.

imit dhe stereotipave ndaj fëmijëve me handikap, si dhe qasjen e vazhdueshme ndaj izolimit dhe institucionalizimit;

(d) Mungesa e ndërhyrjes së hershme dhe e politikave/dispozitave për shërbime të pavarura të jetesës;

(dh) Mungesën e mekanizmave me të cilat do të sigurohej pjesëmarrja e fëmijëve me handikap në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në jetën e tyre.

Në veçanti, ekziston mungesa e mekanizmave me të cilat do të sigurohet dhe do të merret parasysh mendimi i fëmijëve me handikap për çështjet që lidhen me to dhe familjet e tyre, si dhe pjesëmarrja e tyre në të gjitha mekanizmat mbrojtës.

(d) Të miratohen masa për tejkalimin e stigmatizimit dhe luftës kundër diskriminimit, si dhe stereotipat kundër fëmijëve me handikap;

(dh) Të sigurojë përkrahje të vazhdueshme për fëmijën nga ndërhyrja e hershme deri te jetesa e pavarur;

(e) Të promovohen strategji gjithëpërfshirëse dhe mekanizma për pjesëmarrjen e plotë të fëmijëve me handikap në konsultime, në proceset e vendimmarrjes dhe politikave, përmes organizatave reprezentative me qëllim që të promovohet zgjedhja adekuate e shërbimeve që më së miri u përgjigjen nevojave të fëmijëve, duke marrë parasysh aftësitë e fëmijëve që zhvillohen.

Fëmijët me handikap (neni 7)

Vërejtje

Rekomandime

Komiteti (paragrafi 15) është i shqetësuar për:

(a) Mungesën e legjislacionit specifik për të drejtat e fëmijëve me handikap;

.....

(ç) Ekzistimin dhe mbisundimin e stigmatizimit, diskriminimit

Komiteti (paragrafi 16) i rekomandon shtetit:

(a) Të miratojë legjislacion të posaçëm, sa u përket të drejtave të fëmijëve me handikap;

.....

(ç) Të vihen në fokus të drejtat e fëmijëve me handikap, duke përfshirë parimin e interesit më të mirë për fëmijën në të gjitha politikat, planet, programet kombëtare dhe në të gjitha kornizat ligjore gjithëpërfshirëse në lidhje me fëmijët dhe të rinjtë në përgjithësi;



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në arsim


HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në arsim

KREU I

KREU I

Aksesi (neni 9)			
Vërejtje	Rekomandime		
<p>Komiteti vëren se legjislacioni i shtetit ofron një qasje sistematike dhe gjithëpërfshirëse për të drejtën për qasje fizike. Megjithatë, Komiteti është i shqetësuar (paragrafi 19) që:</p> <p>(a) Nuk ka masa dhe sanksione specifike dhe efektive për zbatimin e legjislacionit që siguron qasje në mjedisin fizik dhe në sistemet e informacionit, komunikimit dhe teknologjisë;</p> <p>(b) Qasja në objektet, shërbimet e transportit dhe institucionet publike dhe shërbimet e tjera jashtë kryeqytetit është i pamjaftueshëm,</p>	<p>Sa i përket nenit 9 të Konventës dhe komentit të përgjithshëm nr. 2 (2014), Komiteti rekomandon që shteti-anëtar në përkrahje të realizojë objektivin 9 dhe objektivat 11.2 dhe 11.17 nga “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm” (paragrafi 20):</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Të rishikojë legjislacionin në mënyrë që të sigurojë zbatim të detyrueshëm i standardeve të aksesueshmërisë në të gjitha fushat, në veçanti qasjen në objektet, shërbimet e transportit, objektet dhe shërbimet e tjera të hapura për publikun, si dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit dhe të vendosë sanksione të rrepta për ata nuk do t’i zbatojnë ; (b) T’i vendos standartet për akses si kusht në të gjitha furnizimet publike dhe shërbimet dhe ndërtime dhe ta ndjekë implementimin; (c) Të sigurohet se aksesin në ndërtesa, transport, teknologji dhe sisteme të informacionit dhe komunikimit, si dhe 	<p>ku ekziston mungesë e zbatimit të të gjitha standardeve ndërkombëtare të aksesit në aeroportin ndërkombëtar;</p> <p>(c) Niveli i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qeveritare dhe agjencive me organizatat e personave me handicap, sa i përket implementimit dhe monitorimit të standardeve të aksesit është minimal;</p> <p>(ç) Legjislacioni nuk siguron qasje sistematike ose të plotë në ushtrimin e të drejtës për qasje në informacione dhe komunikime, duke përfshirë teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit.</p>	<p>objektet dhe shërbimet për publikun dhe institucionet publike dhe shërbimet janë të disponueshme në tërë territorin e shtetit-anëtar;</p> <ul style="list-style-type: none"> (ç) Të përshpejtohet miratimi i një plani gjithëpërfshirës kombëtar të veprimit për zbatimin e standardeve të aksesueshmërisë në konsultim të ngushtë me organizatat e personave me handicap, me një afat kohor të përcaktuar qartë, si dhe me kritere të përcaktuara qartë të monitorimit dhe vlerësimit.



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në arsim

KREU I

Liria e shprehjes dhe e mendimit dhe qasja në informacione (neni 21)

Vërejtje

Komiteti është i shqetësuar për vëllimin e kufizuar të informacioneve të karakterit publik që është në dispozicion për personat me handicap, duke përfshirë interpretimin e gjuhës së shenjave dhe formateve taktile, siç është alfabeti Braj, formate lehtë të lexueshme dhe forma të tjera alternative të komunikimit në mediat publike dhe private.

Komiteti, po ashtu, është i shqetësuar për shkak të mungesës së standardizimit, njohjes dhe zbatimit të gjuhës së shenjave si gjuhë zyrtare (neni 38).

Rekomandime

Komiteti (neni 39) i rekomandon shtetit:

- (a) Të miratojë ligj për të drejtën e qasjes në informata dhe eliminimin e të gjitha kufizimeve që e vështirësojnë ushtrimin e të drejtës së personave me handicap në lirinë e tyre për të kërkuar dhe marrë informacione dhe të japin informacione dhe ide në baza të barabarta me të tjerët, si dhe të sigurojë që ueb faqet të jenë të disponueshme për personat me handicap, veçanërisht për ata që janë të verbër ose me shikim të dëmtuar;
- (b) Të ndërmerren masa konkrete juridike dhe masa për zbatim, në mënyrë që të standardizohet, të njihet dhe të përdoret gjuha e shenjave si gjuhë zyrtare që duhet të ligjërohet në shkolla, të formohet grup i përkthyesve të kualifikuar të gjuhës së shenjave dhe mësues me shkathtësi për njohjen taktile, alfabetin Braj dhe shkathtësi për të përshtatur tekstin në një format të lehtë të lexueshëm, si dhe të sigurohet që, stacionet televizive dhe programet, të ofrojnë në formate të aksesueshme, veçanërisht për personat të cilët janë të shurdhër, persona të shurdhër – të verbër apo që kanë vështirësi gjatë dëgjimit.

KREU II

KORNIZA JURIDIKE KOMBËTARE



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

1. Legjislacioni i vendit dhe harmonizimi i tij me KDPH

Legjislacioni kombëtar mbulon disa dispozita që kanë të bëjnë drejtpërdrejt ose tërthorazi me personat me handicap në sferën e arsimit.

Legjislacioni në sferën e arsimit, nga aspekti i mbrojtjes kundër diskriminimit ndaj komunitetit me aftësi të kufizuar nuk ofron qasje sistematike për realizimin e së drejtës për arsimim pa diskriminim dhe në baza të barabarta me të tjerët. Ligji për arsim fillor¹⁶ (në tekstin e mëtejme: LAF), Ligji për arsim të mesëm¹⁷ (në tekstin e mëtejme: LAM), Ligji për arsimin e lartë¹⁸ (në tekstin e mëtejme: LAA) përmbajnë dispozita për mbrojtjen kundër diskriminimit, por në

të njëjtat baza e aftësive të kufizuara nuk është përfshirë. Korniza ligjore nuk e rregullon të drejtën e përshtatjes së arsyeshme dhe mbështetjes individuale e as format e komunikimit, që lë një hapësirë mjaft të gjerë për përjashtimin e fëmijëve me handicap nga sistemi i rregullt arsimor, si në shkollat shtetërore, po ashtu edhe në ato private.


Propozim-ligji i ri i arsimit fillor¹⁹ e ka përfshirë bazën aftësive të kufizuara në mbrojtjen nga diskriminimi, duke i klasifikuar nxënësit me handicap si “nxënës me funksionalitete të ndryshme”. Me këtë klasifikim, propozim-ligji i ri i arsimit fillor vë në dukje përfshirjen e kushtëzuar të nxënësve me handicap në varësi të shkallës së funksionalitetit të tyre dhe ruajtjen e qasjes mjekësore ndaj çështjes së aftësive të kufizuara.

¹⁶[Ligji i arsimit fillor, Tekst i konsoliduar, („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017),MASH, Në dispozicion në: <<http://www.mon.gov.mk> >]

¹⁷[Ligji i arsimit të mesëm, Tekst i konsoliduar, („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017),MASH, Në dispozicion në: <<http://www.mon.gov.mk> >]

¹⁸[Ligji i arsimit të lartë, MASH, Në dispozicion në: < http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/ZAKON_VISOKOTO_OBRAZOVANIE-final.pdf >]

¹⁹[Propozim-ligji i arsimit fillor, MASH 2018, Në dispozicion në: < <http://www.mon.gov.mk> >]



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Duke pasur parasysh KDPH-në (neni 24-b), korniza ligjore në fushën e arsimit, përfshirë edhe propozim-ligjin e ri të arsimit fillor, nuk lejojnë që personat me handicap të kenë qasje në arsimin inkluziv cilësor dhe pa pagesë të arsimit fillor dhe të mesëm. Në këtë drejtim, sistemi arsimor nuk e mbulon plotësisht dhe nuk e rregullon çështjen e qasjes, pranimit dhe përshtatjes, me çka nxënësit me handicap janë plotësisht në pozitë të papërshtatshme krahasuar me nxënësit tjerë pa handicap.

Sa i përket mbështetjes për nxënësit me handicap, propozim-ligji i ri i arsimit fillor, përveç masave të llojllojshme (shërbime dhe qendra) që duhet të ofrojnë mbështetje për nxënësit me handicap, nuk kanë ndonjë qëllim dhe nuk kanë për qëllim ofrimin e qasjes efektive në arsim, që do të kontribuojë për të arritur integrimin e plotë social të mundshëm dhe zhvillimin individual të nxënësve me handicap.

Në të njëjtin propozim-ligj për arsimin fillor mungon plotësisht përkrahja individuale dhe përshtatja e arsyeshme. Përveç kësaj nëpërmjet sistemit të propozuar shihet mosnjohja e shërbimeve mbështetëse, kështu që është përzier shërbimi i asistencës personale me asis-

tentët edukativë. Shërbimet e propozuara janë tërësisht të pa harmonizuara me nenin 19 të KDPH dhe komentin e përgjithshëm nr. 5 të OKB-së të Komitetit për të Drejtat e Personave me Handikap për Nenin 19.

Edhe përpos përpjekjeve për arsim gjithëpërfshirës, sistemi ekzistues në mënyrë të ndjeshme promovon segregimin dhe përfshirjen e nxënësve me handicap në shkolla speciale ose në klasa të veçanta në shkollat e rregullta. Përveç segregimit, fokusohet në aftësitë e kufizuara faktike apo perceptim dhe “dëmtimeve” dhe kufizimin e mundësive të bazuara në supozimet paraprakisht të definuar dhe negative rreth potencialit të personave me handicap. Një qasje e tillë mjekësore defektologjie reflektohet plotësisht në programet arsimore.

Ky sistem i këtillë nuk lejon që personat me handicap të kenë arsim të barabartë cilësor në të njëjtën bazë me të tjerët, dhe janë të detyruar të edukohen për vende pune që janë larg arritjes së potencialit dhe talentit të tyre. Për shembull, në LAM thuhet se: “Në arsimin e mesëm për nxënësit me handicap edukohen nxënës sipas programeve për profesione adekuate, respektivisht në profile arsimore apo për aftësim për punë”.

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Programet specifike dhe speciale të hartuara nëpërmjet Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (në tekstin e mëtejme: BZHA) janë reduktuar plotësisht në qasjen mjekësore dhe të bazuar në “dëmtimet” ose “funksionalitetin” e personave me handicap. Programi i përgjithshëm arsimor nuk ofron plane mësimore fleksibile dhe metoda për mësim të përshtatura për përparësi të ndryshme, kërkesa dhe stile të mësimin. Ndaj, me këtë edhe kuadri që del nga fakultetet arsimore nuk janë të edukuar në lidhje me çështjen e aftësive të kufizuara nga aspekti i të drejtave të njeriut e as nuk janë të trajnuar për të punuar me nxënës me handicap.


Përkundër mungesës së një sistemi arsimor për edukimin e mësuesve, paradoks shtesë janë pikët e vendosura, ku inkluzioni vlerësohet me pikë. Sipas Ligjit të Inspektionit arsimor²⁰, pikat bazohen në atë nëse mësimmshënësi ka realizuar mësim në klasë të rregullt me nxënës me “nevoja të veçanta arsimore” (8 pikë) ose punon pjesërisht (4 pikë).

Programet arsimore nuk përmbajnë dispozita me të cilat do të promovoheshin dhe zbatoheshin format e ndryshe e as dispozita ku do të qëndronte detyrimi që të njëjtat duhet të jenë në formate të aksesueshme. Kjo praktikë është pasqyruar edhe në Ligjin për tekste shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm²¹. Në Ligj nuk është theksuar se librat shkollorë duhet të përpilohen edhe në format që do të jenë në dispozicion për të gjithë nxënësit, pa marrë parasysh llojin e aftësive të kufizuara, duke përfshirë edhe libra elektronikë në formë të qasshme, libra me alfabet Braj, libra që janë lehtë të lexueshëm dhe në audio-format, si dhe përdorimi i gjuhëve, duke marrë parasysh përkatësinë etnike të nxënësit me aftësi të kufizuara.

Programet arsimore gjithëpërfshirëse doemos duhet të kenë për qëllim promovimin e respektit të ndërsjellë dhe vlerës për të gjithë personat, duke përfshirë edhe personat me handicap dhe të ndërtojnë mjedise arsimore në të cilat qasja në të mësuarit është kultura e një

²⁰[Indikatorët për cilësinë e punës së shkollave, MASH, Në dispozicion: <http://mirceacev-lisicani.weebly.com/uploads/2/5/2/8/25280659/indikator.pdf>]

²¹[Ligji i teksteve shkollorë për arsim fillor dhe të mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 120/2013, 29/2014, 146/2015, 217/2015 dhe 30/2016)]



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

institucioni arsimor. Këto karakteristika janë lënë jashtë planit-programit ekzistues për personat me handicap.

Ligji i mësimdhënësve²² (neni 18) në pjesën e kompetencave themelore profesionale të mësimdhënësve thotë se “përfshirja sociale dhe arsimore është një nga fushat në të cilat mësuesit duhet të kenë vlera dhe njohuri profesionale dhe mirëkuptim, si dhe aftësi dhe kompetenca profesionale”, pa u marrë parasysh dispozitat e KDPH-së dhe detyrimet e mësuesve.

Trajnimi i kuadrit mësimor, lidhur me çështjen e aftësive të kufizuara, shumë shpesh zhvillohet përmes projekteve dhe përkrahjen nga fondacionet dhe institucionet ndërkombëtare, pa ndonjë strategji të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejme: MASH) dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit

për përfshirjen aktive të fëmijëve dhe nxënësve me handicap në sistemin e rregullt arsimor në baza të njëjta me të tjerët²³.

Në sistemin e përgjithshëm të krijimit të kuadrit mësimor mungojnë masat për punësimin e administratës, të kuadrit mësimor dhe jomësimor me shkathtësi që në mënyrë efektive të punojnë në mjediset arsimore gjithëpërfshirëse, të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/ose me alfabetin Braj, si dhe orientim dhe mobilitet.

Në këtë linjë janë edhe dispozitat e Ligjit për arsim profesional dhe trajnim, të Ligjit për arsimin e të rriturve dhe Ligjin e standardit të nxënësve²⁴. Në to, përpos mungesës së klauzolës për mbrojtje nga diskriminimi, të njëjtat nuk i përfshijnë parimet e qasjes, barazisë dhe përshtatjes adekuate.

²²[Ligji për arsimtarët në shkollat fillore dhe të mesme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 10/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017)]

²³ [Shih: Raport nga organizatat e personave me handicap dhe organizatave të qytetarëve për implementimin e KDPH, i dorëzuar për shqyrtim në sesionin e 20-të të OKB Komiteti mbi të drejtat e personave me handicap, viti 2018. Në dispozicion: < https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=INT%2fCRPD%2fCSS%2fMKD%2f31979&Lang=en >]

²⁴ [Ligji për standardet e nxënësve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 52/2005, 117/2008, 17/2011, 135/2011, 15/2013, 41/2014, 146/2015 dhe 30/2016)]

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Nga të gjitha dispozitat ligjore të lartpërmendura, sa i përket mbrojtjes kundër diskriminimit, përjashtim bën Ligji për mbrojtjen e fëmijëve (në tekstin e mëtejme: LMF) LMF e parashikon bazën e mbrojtjes së fëmijëve me “nevoja të posaçme arsimore” nga diskriminimi (neni 12 LMF). Përveç mbrojtjes nga diskriminimi, ligji nuk parashikon obligimin për sigurimin e përshtatjes së arsyeshme e as dispozita për inicimin e masave për përfshirjen e fëmijëve me handicap në institucionet parashkollore, pa marrë parasysh aftësitë e kufizuara të tyre në një bazë të barabartë me fëmijët tjerë, si dhe as masa me të cilat mund të hiqet animoziteti ndaj përfshirjes së fëmijëve me handicap në kopshte nga publiku i përgjithshëm dhe stafi i institucioneve²⁵. Për më tepër, akoma nuk janë miratuar programet për arsim dhe edukim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, që duhet t’i hartojë BZHA në këtë sferë.

Nga ana tjetër, Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi²⁶ (në tekstin e mëtejme: LPMD) e ka parashikuar bazën e aftësive të kufizuara në mbrojtjen nga diskriminimi dhe, në mënyrë paralele, parashikon edhe dispozita me të cilat mospërshtatja e aksesit dhe përshtatjes adekuate do të konsiderohet diskriminim në sferën e arsimit.

Korniza e përgjithshme ligjore në fushën e arsimit nuk përmban asnjë dispozitë, përmes të cilave do të identifikoheshin barrierat materiale, fizike, gjuhësore, komunikuese, financiare, ligjore dhe të tjera për arsimim në të gjitha nivelet, me çka personave me handicap do t’u ishte mundësuar arsimim në të gjitha nivelet me bazë të barabartë me të tjerët.

Paralelisht me këtë, sistemi nuk ka për obligim që, gjatë krijimit të politikave dhe buxheteve për institucionet arsimore, të njëjtat të përpilohen nga aspekti i çështjes së aftësive të kufizuara, si dhe

²⁵ [Shih: Najčevska M., Kadriu B., Jandrijska Jovanova K., Čavkovska B., Mora Bajrami V., Të padukshëm për shoqërinë, Vlerësim i gatishmërisë për ratifikimin e Konventës mbi të drejtat e personave me pengesa, Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni, Shkup, viti 2011. Në dispozicion në: <<http://soros.org.mk/dokumenti/FOOM-Nevodlivi-za-opstestvoto-MK.pdf>>.]

²⁶ [Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 50/2010, i datës 13 prill 2010. Në dispozicion në: <<http://www.mtsp.gov.mk>> dhe <<http://www.slvesnik.com.mk>>.]



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

KREU II

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

KREU II

obligimin për përfshirjen e detyrueshme të personave me handicap, duke përfshirë fëmijët me handicap në të gjitha proceset në sistemin arsimor.

Kategorizimi i fëmijëve dhe të rinjve me handicap është një problem i madh në sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës. Kategorizimi i fëmijëve me handicap bazohet në qasjen mjekësore, ku është lënë jashtë tërësisht qasja ndaj të drejtave të njeriut. Kjo qasje i kufizon institucionet arsimore për të ndërmarrë hapa më seriozë në ushtrimin e së drejtës për arsimim për personat me handicap dhe për të siguruar përfshirjen e tyre në sistemin e arsimit të rregullt në bazë të barabartë me fëmijët e tjerë.

Mungesa e stafit të kualifikuar dhe të përkushtuar shkollor, mungesa e infrastrukturës adekuate për qasje, si dhe mungesa e shërbimeve të vendosura dhe të zhvilluara për përkrahje dhe mungesa e mirëkuptimit dhe kapacitetit mbeten pengesa të rëndësishme për arsimin gjithëpërfshirës.

2. Statistika dhe të dhëna në nivel kombëtar

Sistemi arsimor i Republikës së Maqedonisë organizohet përmes arsimit parashkollor, fillor, të mesëm dhe të lartë.

Arsimi special për fëmijët me handicap është një praktikë në vend, pavarësisht nga fakti se neni 24 i KDPH shtetit i imponon detyrimin për të siguruar dhe garantuar aksesin për fëmijët me handicap në “arsim fillor dhe të mesëm inkluziv, cilësor dhe pa pagesë në mënyrë të barabartë me të tjerët në komunitetet në të cilat ata jetojnë”.

Arsimi fillor zgjat nëntë vjet dhe është i detyrueshëm dhe pa pagesë për të gjithë nxënësit (të moshës 6-14 vjeç). Në vendin tonë ka 1.100 shkolla fillore (duke përfshirë edhe ato rajonale). Numri i përgjithshëm i nxënësve në vitin shkollor 2016/2017 ishte 190,225 në arsimin fillor²⁷.


Në pajtim me të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikës (në tekstin e mëtejshëm ESHS), në pasqyrën statistikore për shkollat fillore dhe të mesme janë evidentuar 45 shkolla speciale për fëmijë “me pengesa në zhvillimin mental”, 1 shkollë fillore për fëmijët me dëgjim

të dëmtuar, 1 shkollë fillore për fëmijët me shikim të dëmtuar, 1 shkollë fillore për fëmijët me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folurit, 1 shkollë fillore për fëmijët me handicap fizike dhe 1 shkollë fillore për fëmijët me pengesa edukative.

Tabela 1: Prezantim i shkollave të rregullta fillore, sipas viteve dhe numrit të nxënësve

Shkolla fillore të rregullta dhe numri i nxënësve	Shkolla	Klasa	Nxënës			
			Gjithsej	nxënëse	Nxënës që e kanë përfunduar shkollën	
					Gjithsej	Nxënëse
2012/2013	990	10 657	194 055	94 309	22 955	11 147
2013/2014	990	10 664	190 541	92 542	21 355	10 365
2014/2015	989	10 689	188 361	91 397	21 641	10 520
2015/2016	990	10 621	185 119	89 755	16 710	8 021
2016/2017	991	10 830	190 225	92 103	20 662	10 006

²⁷[Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2016/2017, Pasqyrë statistikore nr. 2.4.18.05/896, Enti Shtetëror i Statistikës, 2018, faqe 10. Në dispozicion në <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.05.pdf>]



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Tabela 2: Prezantim i shkollave fillore speciale, sipas viteve dhe numrit të nxënësve (Në këtë tabelë janë mënjeluar të dhënat për shkollën speciale për fëmijët me pengesa edukative)

Shkollat fillore speciale/Viti	Shkolla	Klasa	Nxënës		
			Gjithsej	Nxënëse	Nxënës që e kanë përfunduar shkollën
					Gjithsej
2012/2013 ²⁸	44	166	895	292	133
2013/2014 ²⁹	44	170	793	273	94
2014/2015 ³⁰	43	180	815	291	86
2015/2016 ³¹	44	173	727	248	101
2016/2017 ³²	44	200	1 206	481	132

Sipas të dhënave të ESHS mund të vërehet se në vitin shkollor 2016/2017 ka rritje për 40% të numrit të përgjithshëm të nxënësve me handicap në shkollat fillore speciale, në krahasim me vitin shkollor 2015/2016.

Nëse bëjmë krahasimin e të dhënave nga shkollat fillore të rregullta me të dhënat e shkollave speciale mund të shihet se është më i vogël numri i pjesëmarrjes së fëmijëve/nxënësve me handicap në arsimin fillor. Në vitin shkollor

²⁸ Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2012/2013 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.18.05/896, Enti Shtetëror i Statistikës, 2014, faqe 40. Në dispozicion në <<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.05.pdf>>

²⁹ Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2013/2014 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.15.07/816, Enti Shtetëror i Statistikës, 2015, faqe 40. Në dispozicion në: <<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.15.07.pdf>>

³⁰ Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2014/2015 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.16.06/851, Enti Shtetëror i Statistikës, 2016, faqe 40. Në dispozicion në: <<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.16.06.pdf>>

³¹ Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2015/2016 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.17.05/874, Enti Shtetëror i Statistikës, 2017, faqe 40. Në dispozicion në: <<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.17.05.pdf>>

³² Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2016/2017 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.18.05/896, Enti Shtetëror i Statistikës, 2018, faqe 40. Në dispozicion në: <<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.05.pdf>>

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

KREU II

2016/2017 numri i përgjithshëm i nxënësve ka qenë 190.225 në shkollat e rregullta, ndërsa përfaqësimi i nxënësve me handicap është 0.65% edhe atë në shkollat speciale.

Duke pasur parasysh faktin se 10-15% e numrit të përgjithshëm të nxënësve i takojnë kategorisë së nxënësve me aftësi të kufizuar, ky indikator tregon se fëmijët/nxënësit me aftësi të ku-

fizuar nuk janë përfaqësuar dhe nuk janë përfshirë në sistemin arsimor.


Në mënyrë plotësuese, ekziston mos-konsistencë e të dhënave nëpër institucione. Kjo mund të vërehet edhe nga të dhënat e marra nga MASH dhe të dhënat nga ESHS lidhur me shtesën e posaçme dhe kompensimet nga mbrojtja sociale.

Sipas të dhënave në Pasqyrën statistikore nr. 2.4.18.10/901³³ (Grafiku 1) në vitin 2016 numri i përgjithshëm i nxënësve që kanë qenë përfitues të shtesës së posaçme për fëmijë ka qenë 7.346, ndërsa në vitin 2017 – 7.301. Sipas Pasqyrës së njëjtë, numri i personave të mitur me aftësi të kufizuar, përfitues të mbrojtjes sociale, sipas gjinisë dhe moshës në vitin 2017 ka qenë 3.118 përfitues (në këtë numër nuk janë përfshirë përfituesit e mbrojtjes sociale të moshës 18-26 vjeç) dhe, nëse i heqim vetëm personat e moshës 7-15 vjeç, numri i përfituesve ka qenë 1.729 (tabela 3)

Shifrat tregojnë se një numër i madh i përfituesve të shtesës së posaçme për

Në përputhje me evidencën e MASH, e në bazë të të dhënave të dorëzuara nga drejtoritë e të gjitha shkollave fillore dhe të mesme shtetërore dhe komunale, në vitin e kaluar shkollor 2017/2018 ka pasur 1.246 filloristë me nevojë të posaçme arsimore, prej të cilëve 431 në shkollat fillore të posaçme dhe 815 nxënës në shkollat fillore të rregullta.

³³ Mbrojtja sociale e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve, 2017, Pasqyrë statistikore nr. 2.4.18.10/901, Enti Shtetëror i Statistikës, 2018. Në dispozicion në: <<http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=22>>



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Grafiku 1




Tabela 3: Numri i përfutësve me handicap të mbrojtjes sociale sipas gjinisë dhe moshës, viti 2017

Ekstrakt nga T-05: Përfutës të mitur me aftësi të kufizuara të mbrojtjes sociale, sipas gjinisë dhe moshës, 2017		Gjithsej	Moshë				
			më pak se 7 vjeç	7-13	14-15	16-17	18-26
Persona me shikim të dëmtuar	Gjithsej	285	48	92	30	21	94
	femra	91	23	39	13	6	10
Persona me dëmtim të dëgjuar	Gjithsej	270	41	90	61	43	35
	femra	92	21	35	18	10	8
Persona me pengesa në komunikimin verbal	Gjithsej	84	22	25	17	9	11
	femra	32	10	12	4	2	4
Persona me invaliditet fizik	Gjithsej	817	247	208	96	123	143
	femra	332	115	81	35	51	50
Persona me pengesa në zhvillimin mental	Gjithsej	1 364	217	389	274	199	285
	femra	552	87	158	125	81	101
Autizëm	Gjithsej	97	40	46	6	3	2
	femra	18	7	9	1	-	1
Persona me pengesa të kombinuara në zhvillim	Gjithsej	948	242	299	96	134	177
	femra	378	107	118	37	48	68

HALLKA QË MUNGON


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

fëmijë të mbrojtjes sociale nuk janë se edhe këta persona të evidentuar, sipas përfshirë në arsimin fillor. Nëse këto të kategorive, janë humbur nëpër labirintet dhëna i shikojmë nëpërmjet kategorive e sistemit. të personave me handicap, do të vërejmë

Tabela 4: Numri i shkollave fillore speciale, klasat dhe nxënësit

2016/2017	Shkolla	Klasa	Nxënës			
			gjithsej	nxënëse	e kanë kryer klasën	e kanë kryer shkollën
Gjithsej	44	200	113	481	1068	132
Shkolla për fëmijë me pengesa në zhvillimin mental	40	168	1 093	440	965	126
Shkolla për fëmijë me dëgjim të dëmtuar	1	14	61	21	61	3
Shkolla për fëmijë me shikim të dëmtuar	1	10	32	15	32	1
Shkolla për fëmijë me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folurit	1	2	10	3	10	1
Shkolla për fëmijë me aftësi të kufizuara fizike	1	6	10	2	-	1



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Nëse bëjmë krahasim të tabelës 3 dhe 4, lidhur me kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, mund të vërejmë se gjithsej 523 persona/fëmijë nuk janë përfshirë në arsim, prej të cilëve 17 persona me handicap intelektual, 90 persona me dëgjim të dëmtuar, 90 persona me pamje të dëmtuar, 32 persona/fëmijë me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folurit dhe 294 persona/fëmijë me handicap fizike.

Me decentralizimin e shkollave u krijua një gjendje ku janë lënë anash politikat lokale për inkluzivitet. Për ata nxënës që ndjekin shkollën, zgjedhja e tyre është një shkollë e rregullt apo

Paralele të këtitlla ka në 21 shkolla në 18 komuna dhe janë pjesë përbërëse të shkollave fillore që tani janë në kompetencë të komunave. Këto klasa funksionojnë si mjedise me “kushte të posaçme” në kuadër të shkollave të rregullta.

Deklaratë e një pjesëmarrësi në intervistë

shkollë speciale. Po ashtu, ekzistojnë edhe paralele për nxënësit me handicap në shkollat fillore të rregullta.

Edhe në këtë qasje për fëmijët me handicap të vendosur në klasa të posaçme – mbase janë nën kulmin e njëjtë, megjithatë, në praktikë ata janë të ndarë nga moshatarët e tyre, ku mësimin e ndjekin me orar të shkurtuar dhe u është shkurtuar e drejta për qëndrim të zgjatur.

Nëpërmjet të dhënave ekzistuese mund të vërehet edhe ndasia gjinore te personat me handicap. Në fakt, nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të evidentuar me aftësi të kufizuar (Tabela 3) 40% e fëmijëve janë të gjinisë femërore, ku përfaqësim më të vogël ka të vajzave me handicap te fëmijët me handicap fizike (20%).

Mungesa e statistikave për popullatën me handicap është një faktor shumë i kufizuar në përcaktimin e numrit të personave me handicap që janë përfshirë në klasat e rregullta, sa janë ndarë në klasa të veçanta në shkollat e rregullta dhe sa nga fëmijët me aftësi të kufizuar e realizojnë arsimin e tyre ekskluzivisht në shkolla speciale, si institucione të veçanta.

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Shteti duhet të obligojë çdo institucion arsimor të mbajë evidencë dhe statistika mbi numrin e personave me handicap të përfshirë në sistemin arsimor, të shpërndarë sipas kategorive të aftësisë së kufizuar, në përputhje me nenin 2 të KFPK, duke marrë parasysh edhe aspektin gjinor.

Nga numri i përgjithshëm i shkollave të mesme ekzistuese (116), më shumë se 100 janë publike, ndërsa të tjerat janë private apo religjioze. Përafërsisht 14% e shkollave të mesme janë gjimnaze, 34.5% janë profesionale, ndërsa 29% ofrojnë gjimnaz dhe arsim profesional; 4 shkolla janë për fëmijët me handicap dhe 5 janë shkolla arti.

Tabela 5: Numri i përgjithshëm i shkollave të mesme të rregullta, klasave, nxënësve 2013 -2017³⁴

T-29: Shkolla të rregullta, klasa, nxënës	Shkolla	Klasa	Nxënës			
			Gjithsej	Nxënëse	Nxënës që e kanë kryer shkollën	
					Gjithsej	Nxënëse
2012/2013	113	3 467	88 582	42 506	25 546	11 916
2013/2014	115	3 457	84 827	40 649	23 936	11 100
2014/2015	118	3 494	81788	39 533	23 516	11 057
2015/2016	121	3 447	77 625	37 267	21 957	10 248
2016/2017	131	3 481	72 482	34 874	21 577	10 171

³⁴[Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2016/2017, Pasqyrë statistikore nr. 2.4.18.05/896, Enti Shtetëror i Statistikës, 2018, faqe 44. Në dispozicion në: < <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.05.pdf>>]



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Tabela 6: Numri i përgjithshëm i shkollave të mesme speciale, klasat, nxënësit me handicap, periudha vjetore 2013 -2017

T-45: Shkolla të mesme speciale, klasa, nxënës	Shkolla	Klasa	Nxënës			
			gjithsej	nxënëse	nxënës që e kanë kryer shkollën	
					gjithsej	nxënëse
2012/2013 ³⁵	4	57	289	87	272	97
2013/2014 ³⁶	4	58	279	80	256	79
2014/2015 ³⁷	4	59	260	74	258	72
2015/2016 ³⁸	4	60	236	64	234	70
2016/2017 ³⁹	4	61	221	64	221	82

³⁵ Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2012/2013 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.18.05/896, Enti Shtetëror i Statistikës, 2014, faqe 62. Në dispozicion në: < <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.05.pdf>

³⁶Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2013/2014 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.15.07/816, Enti Shtetëror i Statistikës, 2015, faqe 62. Në dispozicion në: < <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.15.07.pdf>

³⁷Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2014/2015 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.16.06/851, Enti Shtetëror i Statistikës, 2016, faqe 62. Në dispozicion në: < <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.16.06.pdf>

³⁸Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2015/2016 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.17.05/874, Enti Shtetëror i Statistikës, 2017, faqe 62. Në dispozicion në: < <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.17.05.pdf>

³⁹Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2016/2017 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.18.05/896, Enti Shtetëror i Statistikës, 2018, faqe 62. Në dispozicion në: < <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.05.pdf>

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat e mesme të rregullta në vitin shkollor 2016/2017 ka qenë 72.482 (Tabela 5), derisa numri i nxënësve me handicap në vitin shkollor 2016/2017 ka qenë 221 (Tabela 6).


Nga analogjia e pjesëmarrjes së nxënësve me handicap në arsimin fillor dhe në arsimin e mesëm në vitin shkollor 2016/2017, përfaqësimi i nxënësve me handicap është 0.3%, i përgjysmuar

nga pjesëmarrja e nxënësve me aftësi të kufizuar në arsimin fillor për vitin shkollor 2016/2017.

Arsimi i mesëm special për fëmijët me handicap është organizuar në 4 institucione, prej të cilave 2 janë shkolla të mesme për personat me handicap intelektual, 1 shkollë për personat me shikim të dëmtuar dhe 1 shkollë për personat me dëgjim të dëmtuar dhe me pengesa në të folur (Tabela 7).

Tabela 7: Shkollat e mesme speciale, sipas llojit të pengesës së nxënësve, 2016/2017

T-49: Shkolla të mesme speciale sipas llojit të pengesës së nxënësve, 2016/2017	Shkolla	Klasa	Nxënës			E kanë kryer shkollën	
			Gjithsej	Nxënëse	e kanë kryer vitin	Gjithsej	Nxënëse
Gjithsej	4	61	221	64	221	82	21
Për persona me pengesa në zhvillimin mental	2	41	169	42	169	60	13
Për të verbër dhe me shikim të dobët	1	8	17	10	17	7	3
Për të shurdhër me dëgjim të dobët	1	12	35	12	35	15	5



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Duke i pasur parasysh të dhënat nga arsimit fillor special (Tabela 2), mund të vërehet se një numër i vogël i nxënësve me handicap e vazhdojnë arsimimin.

Kualifikimet e personave me aftësi të kufizuar në këto shkolla të mesme janë në 7 sfera. Problemi me këto drejtime është se nuk janë me vëllim dhe cilësi të njëjtë sikurse të shkollat e mesme të rregullta. Nxënësit që shkollohen në shkollat e specializuara zakonisht nuk pajisen me diploma të njohura dhe kanë akses të kufizuar në arsimin e mesëm dhe të lartë. Edhe përpos të dhënave të pamjaftueshme të besueshme, duket se

Në përputhje me evidencën e MASH, e në bazë të të dhënave të dorëzuara të drejtorive të shkollave të mesme, në vitin e kaluar shkollor 2017/2018 ka pasur 525 nxënës të shkollave të mesme me nevoja të posaçme arsimore, prej të cilëve 240 në shkollat e mesme për nxënës me nevoja të posaçme dhe 285 nxënës në shkollat e mesme të rregullta.

sapo hyjnë në arsimin special ata shumë rrallë mund të ri-integrohen në arsimin standard. Një qasje e këtillë vetëm mund të thellojë marginalizimin e personave me aftësi të kufizuar në shoqëri dhe e njëjta kontribuon në rritjen e paragjykimëve ndaj tyre.

Në Tabelën 8 mund të shihet se numri më i madh i personave me handicap është në drejtimin grafik. Por, kur bëhet fjalë për drejtimin grafik, nxënësit me handicap marrin diplomë apo aftësohen për lidhës-librash, punëtorë të makinave të shtypit, punëtorë kartonësh, ngjitës dhe punë tjera manuale të sferës grafike. Profesionet e shëndetësisë në arsimin e mesëm profesional katërvjeçar përmban 5 profile arsimore: teknik dhëmbësh, infermiere, teknik i laboratorit mjekësor, teknik i laboratorit farmaceutik dhe teknik fizioterapeutik. Njerëzit me handicap në këtë profesion zakonisht janë në drejtimin si teknik fizioterapeutik.

Kur do të merret parasysh fakti se programet për aftësim për punë janë të vjetruara, ndërsa vendet e punës që aftësohen personat me handicap zakonisht nuk korrespondojnë me nevojat e tregut të punës, lind pyetje nëse

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Tabela 8.⁴⁰ Shkollat e mesme speciale, sipas drejtimit

Shkolla të mesme speciale, nxënës sipas viteve dhe profesionit, 2016/2017	Gjithsëj	Nxënës sipas profesionit									
		bujqësi-veterinari	komunikacion	makineri	elektroteknikë	tekstil	tekstil-lëkurë	grafik	ndërtimari	hoteleri-turizëm	shëndetësi
Gjithsej nxënës	221	15	4	57	10	26	13	57	16	15	8
Nxënëse	64	1	3	-	-	16	12	20	-	8	4
E kanë kryer vitin	221	15	4	57	10	26	13	57	16	15	8
Nxënës sipas viteve											
Viti I											
të gjithë nxënëse	55	4	-	11	3	9	2	20	3	3	-
E kanë kryer vitin	17	-	-	-	-	5	2	8	-	2	-
Viti II											
të gjithë nxënëse	55	4	-	11	3	9	2	20	3	3	-
E kanë kryer vitin	73	4	2	18	3	8	4	15	10	7	2
Viti III											
të gjithë nxënëse	23	1	2	-	-	5	4	5	-	4	2
E kanë kryer vitin	73	4	2	18	3	8	4	15	10	7	2
Viti IV											
të gjithë nxënëse	77	7	2	19	4	9	2	22	3	5	4
E kanë kryer vitin	19	-	1	-	-	6	1	7	-	2	2
Viti V											
të gjithë nxënëse	77	7	2	19	4	9	2	22	3	5	4
E kanë kryer vitin	16	-	-	9	-	-	5	-	-	-	2
Viti VI											
të gjithë nxënëse	5	-	-	-	-	-	5	-	-	-	-
E kanë kryer vitin	16	-	-	9	-	-	5	-	-	-	2

⁴⁰[Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2016/2017 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.18.05/896, Enti Shtetëror i Statistikës, 2018, faqe 63. Në dispozicion në <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.05.pdf>



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

ia vlen ky arsimim, e më pas edhe për mundësitë reale për barazimin e shanseve të personave me aftësi të kufizuara në tregun e përgjithshëm të punës. Pa marrë parasysh potencialet e personave me handicap, në pajtim me kornizën ligjore, ata janë të paracaktuar të arsimohen për vende pune manuale dhe me pagesë të ulët.

Programet mësimore për nxënësit me handicap duhet të drejtohen në profesione më bashkëkohore dhe më të sofistikuar, që kërkohen në tregun e përgjithshëm të punës.

Problem shtesë paraqet, gjithashtu, edhe mungesa e qasjes së vetë institucioneve arsimore për personat me handicap. Problemi është aq i madh sa që edhe shkollat speciale janë të paarritshme (pa akses fizik) për nxënësit me handicap.

3. Perceptimi për diskriminimin në bazë të aftësive të kufizuara

Edhe pse ekziston legjislacioni, megjithatë në praktikë, personat me handicap kanë një nivel më të ulët të pjesëmarrjes në të gjitha fazat e procesit arsimor, veçanërisht në arsimin e mesëm dhe të lartë. Personat me handicap intelektualë janë ata që shpesh nuk e vazhdojnë arsimin e tyre në një nivel më të lartë. Një vështirësi tjetër shtesë është mungesa e qasjes së institucioneve arsimore. Hulumtimet kanë treguar se nga 334 shkolla fillore në vend⁴¹, të analizuar në 238 shkolla, prej tyre pengesa aksesit në hyrje kishin 18.9% e shkollave, hapësira të brendshme të përshtatura (klasa dhe tualete) kishin 10.9% e shkollave dhe asnjëra prej shkollave nuk kishte ashensor të brendshëm. Nga shkollat e analizuar, 74.3% e shkollave përdorin kompjuterë në procesin mësimor, megjithatë vetëm 40.8% e nxënësve me handicap përdorin kompjuterët në mënyrë të barabartë me nxënësit tjerë, kryesisht për

⁴¹[Shih: Raport nga hulumtimi: Zbatimi i teknologjisë informatike asistive në shkollat e rregullta fillore në Maqedoni, nevojat dhe gjendja aktuale, Hapni dyert, Shkup, mars 2011, faqe 9-15.]

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

shkak të papërshtatshmërisë të pajisjeve kompjuterike (pajisje ndihmëse) dhe përshtatshmërive softuerike. Ndërsa në shkollat e mesme profesionale rezultatet tregojnë se 59% e shkollave nuk kanë pengesë, 78% nuk përdorin teknologji ndihmëse, madje vetëm 65% e tyre nuk kanë hapësira të përshtatura⁴².

Sipas hulumtimit “Shkollat e përshtatura për fëmijë”⁴³ 69% e mësimdhënësve që punojnë me fëmijët me “pengesa në zhvillim” në Maqedoni dhe 50% e të gjithë mësimdhënësve konsiderojnë se fëmijët me handicap nuk duhet të përcjellin mësim të rregullt.

Këto vëzhgime janë vërejtur edhe në hulumtimin “Identifikimi i VET politikave dhe praktikave arsimore për përf-

shirjen sociale dhe kohezionin social”, sipas të cilit “ekzistojnë mundësi të kufizuara për arsim dhe fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Kjo lidhet kryesisht me mungesën e kapaciteteve të nevojshme fizike në shkolla, por edhe për shkak të idesë gjerësisht të pranuar që nxënësit me handicap nuk duhet të përzihen me nxënësit e tjerë në mësim të rregullt”⁴⁴.

Në raportin “E drejta për arsimimin e fëmijëve me handicap: qasje në arsim gjithëpërfshirës” është vlerësuar se vetëm 15% e fëmijëve me handicap ndjekin shkollën në vend, kryesisht shkolla speciale dhe stigmatizimi është pengesa kryesore për arritjen e përfshirjes së plotë⁴⁵.

⁴²[Shih: Adrijana Isahi-Pallosi, Lidushka Vasilevska, Lepa Tërçeska, Goran Spasovski, Radmilla Stojkowska-Aleksova, David Crabtree, Inkluzioni në arsimin e mesëm profesional, doracak për punë me nxënësit me nevoja të posaçme, Këshilli Britanik, Shkup, viti 2014, faqe 69]

⁴³[Shih: Publikimi: “Arsimi INKLUZIV në kuadër të shkollave të përshtatura për fëmijë: rezultate dhe rekomandime nga studimi për Maqedoninë” MASH, Në dispozicion në: <[http://www.unicef.org/tfyrmaqedonia/INCLUSIVE_REPORT_MKD\(1\).pdf](http://www.unicef.org/tfyrmaqedonia/INCLUSIVE_REPORT_MKD(1).pdf)>]

⁴⁴[Shih: Raport: “Mapimi i VET praktikave dhe politikave arsimore për inkluzionin dhe kohezionin social në Ballkanin Perëndimor, Turqi dhe Izrael. Raporti për Maqedoninë” viti 2013, Në dispozicion në: <<http://docplayer.net/79775693-Mapping-of-vet-educational-policies-and-practices-for-social-inclusion-and-social-cohesion-in-the-western-balkans-turkey-and-israel.html>>]

⁴⁵[Shih: Zhaneta Poposka, Bekim Kadriu, Elena Grozdanova, Rexhepali Çupi, Elena Koçoska, Analiza e praktikave diskriminuese në sferën e arsimit, OSBE dhe MPPS, Shkup, viti 2014, faqe 103]



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Nga rezultatet e hulumtimit “Studentët me handicap pranë Universitetit ‘Shën Kirili dhe Metodi’ në vitin 2011” vetëm 47 studentë me handicap janë evidentuar në fakultetet pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në vitin 2011. Prej tyre 30 studentë janë me handicap fizike, 2 me dëgjim të dëmtuar, 5 studentë me shikim të dëmtuar, 5 me sëmundje kronike dhe 5 studentë me pengesa të kombinuara në zhvillim.

Shumica e shkollave (70%) gjatë regjistrimit të nxënësve me handicap nuk parashirojnë rezultate dhe mendime nga Enti i Shëndetit Mendor dhe në shkolla nuk ekziston procedurë standarde për identifikimin dhe përcjelljen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Testimi ekstern dhe matura janë procese në të cilat assesit nuk mbahet llogari për qasjen. Gjatë testimit ekstern, nxënësit duhet të përdorin kompjuterë “të rëndomtë”, me çka për disa persona me handicap fizike paraqet sfida të madhe (për shembull, një person i verbër nuk mund të përdorë një lexues të ekranit).

Jo zyrtarisht, rezultatet e nxënësve me handicap nuk bëjnë pjesë në mesataren e shkollave dhe në mesataren e përgjithshme kombëtare (ku bëhet një listë e veçantë dhe pastaj rezultatet e tyre nuk përfshihen kur llogaritet mesatarja)⁴⁶

E drejta për arsim duhet të interpretohet përmes një vizioni të zgjeruar të arsimit që shkon përtej arsimit të detyrueshëm dhe formal. Kjo duhet të përfshijë edhe edukimin parashkollor dhe atë të lartë, por edhe aktivitetet jashtëshkollore dhe arsimin joformal.

Njerëzit me handicap në shoqëri duhet të kenë qasje në mundësi të tilla të të mësuarit në mënyrë të barabartë me të tjerët dhe shteti duhet t’i ofrojë dhe garantojë këto mundësi.

⁴⁶ Shih: Koçoska E., Shavreski Z., Jovanovska V., Llazovski V., Publikimi Analiza e gjendjes së personave me pengesa fizike në Republikën e Maqedonisë”, viti 2016, Komiteti i Helsinkit. Në dispozicion në: < http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/2545/_____5_.pdf

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU II

Avokati i Popullit (në tekstin e mëtejshëm: AP), në Raportin nga vizitën e 6 shkollave të posaçme fillore dhe të mesme të Maqedonisë në vitin 2013, bën me dije se “është e nevojshme përpilimi i teksteve shkollore që do të jenë të përshtatshëm për fëmijët. Shumica e shkollave speciale përballen me mungesën e bashkëpunimit nga ana e prindërve, madje jo i kënaqshëm është edhe bashkëpunimi me institucionet mjekësore, që i japin rezultatet dhe mendimet për aftësitë e kufizuara të fëmijëve”.

Në bazë të situatës së shfaqur, Avokati i Popullit ka vënë në dukje se si shkak më i shpeshtë i braktisjes së parakohshme të arsimit special janë martesat, përkeqësimi i gjendjes shëndetësore, mungesa e kushteve dhe pamundësive për arsimim të mëtejshëm në sistemin e rregullt arsimor për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, si dhe për shkak të favoreve të caktuara të cilat i siguron shteti për grupet e ndryshme të prekshme.

Nga informata e AP mund të shihet se prindërit e fëmijëve me handicap të

moderuar dhe të shumëfishta që marrin shtesa speciale i çregjistrojnë fëmijët nga shkolla, për shkak se me vendosjen e fëmijëve në konvikt kjo shtesë speciale u ndërpritet⁴⁷.

Praktika dhjetëvjeçare e segregimit ka bërë të dukshme pasojat serioze të edukimit të veçantë të fëmijëve. Segregimi shkollor jo vetëm që diskriminon fëmijët dhe cenon të drejtën e tyre për arsimim në baza të barabarta me të tjerët, por edhe i zvogëlon mundësitë për të fituar aftësitë thelbësore të jetës përmes kontaktit me të tjerët; ky shpesh është hapi i parë në rrugën jetësore të shënuar nga segregimi.

⁴⁷ Shih: Raport i Avokatit të Popullit: “Informacion për gjendjen e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të posaçme në shkollat speciale fillore dhe të mesme”, Avokati i Popullit 2013, Në dispozicion në: < <http://ombudsman.mk/upload/documents/2013/Izvestaj-Posebni%20ucilista-2014.pdf> >]

KREU III

Demistifikimi i çështjes së aftësisë së kufizuar në realizimin e së drejtës në arsim



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

1 Objektivi, lënda dhe shembulli i hulumtimit


Analiza – “Hallka që mungon” - është përpiluar në kuadër të projektit “Margina Obscura - çështja e aftësisë së kufizuar në procesin e pranimit në BE” të cilën e realizon Polio Plus - Lëvizja kundër aftësisë së kufizuar.

Qëllimi i analizës ishte që të zbardhet çështja e aftësisë së kufizuar në praktikë ose për të pasqyruar gjendjen aktuale në drejtim të realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar në fushën e arsimit. Analiza është konceptuar si një mjet në duart e aktorëve relevantë në këtë fushë për avancim të praktikës dhe për të harmonizuar dhe përmirësuar kornizën ligjore me KDPH.

Për qëllimet e analizës është krijuar një shabllon prej 1000 kopjeve, prej të cilave 500 prej tyre përfshijnë personat me handicap dhe 500 prindërit e fëmijëve me handicap, duke pasur kujdes në atë që në këtë mjedis të ketë përfaqësues nga të gjitha format e aftësisë së kufizuar.

Në këtë drejtim, nga ana e personave me handicap janë pranuar përgjigjet nga 185 personat me handicap fizike, 145 persona me probleme me shikimin, 140 persona me dëgjim të dëmtuar dhe 30 personat me handicap intelektuale. Prej prindërve të fëmijëve me handicap u morën përgjigje kthyes nga 120 prindërve të fëmijëve me handicap fizike, prindërit e fëmijëve me shikim të dëmtuar - 35, prindërit e fëmijëve me të dëgjim të dëmtuar - 60, prindërit e fëmijëve me handicap të kombinuara - 105 dhe 180 përgjigje nga ana e prindërve të fëmijëve me handicap intelektuale.

Në bazë të informacioneve të marra nga terreni, lidhur me përfaqësimin gjinor, u morën informacione kthyes nga 265 femra dhe 235 meshkuj. Te prindërit e fëmijëve me handicap lidhur me përfaqësimin gjinor janë marrë përgjigje nga 245 meshkuj dhe 225 femra. (Grafiku 3)




HALLKA QË MUNGON


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

Grafiku 2. Shembull nga terreni – persona me handicap, mbi bazën e aftësive të kufizuara



Grafikui 3. Shembull nga terreni – persona me handicap dhe prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuar



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

Lidhur me përkatësinë etnike, 645 pjesëmarrës janë deklaruar si maqedonas, 270 shqiptarë, 25 boshnjakë, 30 turq, 10 vllleh, derisa 20 pjesëmarrës janë deklaruar se janë nga bashkësia rome.

Shikuar nga aspekti i mbulimit territorial, në kuadër të këtij hulumtimi janë përfshirë si zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Përfaqësim më të madh ka në Shkup, ku janë përfshirë 200 anketues, më pas Tetova me 165 anketues, e më pas vijojnë nga Velesi me 80 anketues, Prilepi – 75 anketues, Gostivari -70, Gjevgjelia – 35 anketues, Strumica,

Struga, Radovishi, Ohri, Negotina, Dojrani dhe Vinica – 15 anketues, Gradsko – 30 anketues, Resnja – 25, Probishtipi, Shtipi, Kërçova, Kriva Pallanka dhe Bogovinja me nga 20 anketues, Koçani, Kratova, Kumanova, me nga 10 anketues, Manastiri, Bërvenica, Debarca me nga 5 anketues.

Te personat me handicap dominojnë përgjigjet e anketuesve me handicap të grupmoshave 30-40 vjeç, më pas pasojnë anketuesit e moshave 40-44 vjet, derisa te prindërit më e përfaqësuar është grupmosha 35-39 vjet, më pas vijojnë ata të moshës mbi 50 vjet. (Grafiku 4)

Tabela 9: Shembull nga terreni – persona me aftësi të kufizuar dhe prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuar sipas përfaqësimit etnik


Përfaqësimi etnik	Persona me handicap fizike	Persona me shikim të dëmtuar	Persona me dëgjim të dëmtuar	Personave me handicap kombinuara	Personave me handicap intelektuale	Prindër të fëmijëve me handicap fizike	Prindër të fëmijëve me shikim të dëmtuar	Prindër të fëmijëve me dëgjim të dëmtuar	Prindër të fëmijëve me handicap kombinuara	Prindër të fëmijëve me handicap intelektuale
Maqedonas	110	80	100		25	80	20	50	70	110
Shqiptarë	75	45	20		5	25	10		30	60
Boshnjakë		5	10			5			5	
Turq		10	5			10	5			
Vllleh			5							5
Romë		5						10		5
Total	185	145	140	0	30	120	35	60	105	180

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III


Grafiku 4: Shembull nga terreni – persona me handicap dhe prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuar në bazë të grupmoshave



Struktura arsimore e të anketuesve është e ndryshme, ku më dominuese është arsimi i mesëm të të dy grupet. Te personat me aftësi të kufizuar % është e madhe e personave me arsim fillor, si dhe 18% nuk kanë arsimim formal. Për

dallim nga prindërit, 33% kanë kryer arsimin sipëror, kjo % te personat me aftësi të kufizuar është shumë e ulët – vetëm 8% e të anketuarve kanë treguar se kanë arsimim sipëror.

Grafiku 5: Shembull nga terreni – persona me aftësi të kufizuar dhe prindër të fëmijëve me handicap në bazë të arsimimit



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

2. Analiza kuantitative dhe kualitative e përgjigjeve të pyetësorëve

Në sferën e arsimit, të anketuarit u përgjigjën në 10 pyetje. Në mënyrë plotësuese të anketuarit kishin edhe pyetje për sfera të caktuara, që janë të lidhura ngushtë me gjendjen e aftësive të kufizuara dhe arsimit, dhe për të cilat të dyja grupet tregojnë njohuri të vogla ose nuk i përmendin fare në përditshmëri, edhe përkundër faktit që janë element i rëndësishëm në përcaktimin e politikave arsimore.

Lidhur me diskriminimin, 87% e të anketuarve konsiderojnë se janë të diskriminuar në shoqërinë tonë, ku arsimi gjendet në vendin e tretë - si sferë ku personat me aftësi të kufizuar janë deklaruar se janë të diskriminuar (70,5%).

Një nga obligimet e shtetit, kur i ndërmerret të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e të drejtës për arsim për personat me handicap, është të sigurojë qasjen fizike, pra aksesin deri në ndërtesa, si dhe të sigurojë qasje në të gjitha informatat dhe komunikimet për fëmijët dhe të rriturit me handicap.

Sa i përket qasjes, 85.5% e të anketuarve kanë treguar se institucionet arsimore nuk janë të arritshme, kurse 12% mendojnë se janë pjesërisht të arritshëm, ndërsa 2.5% kanë deklaruar se nuk e dinë (Grafiku 8).

“Nxënësit me handicap duhet të ndjekin shkollat speciale, ku aty do të kenë mësim të përshtatur për ta dhe më lehtë do të mund të gjenden, sepse në ato shkolla ka vetëm fëmijë me handicap”, deklarata nga një pjesëmarrës i grupit të fokusit.

“Në shkolla ka izolim të fëmijëve me handicap, për shkak të nivelit të ulët të vetëdijes tek fëmijët e tjerë, por edhe për shkak të mungesës së teknologjisë ndihmëse dhe pajisjeve të nevojshme për të punuar me fëmijët me handicap. Orët e Edukatës Fizike duhet të zbatohen edhe për fëmijët me handicap, këta aktualisht janë të përjashtuar nga kjo”, deklarata nga një pjesëmarrës i grupit të fokusit.




HALLKA QË MUNGON


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

Grafiku 6. A janë të diskriminuar personat me handicap në shoqërinë tonë?



Grafiku 7. Në cilën sferë të jetës shoqërore personat me handicap janë më shpesh të diskriminuar?



HALLKA QË MUNGON


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

Ky mendim është identik si te prindërit e fëmijëve me handicap ashtu edhe te personat me handicap. 44% e personave me handicap mendojnë se institucionet arsimore nuk janë të arritshme, ndërsa 41.5% e prindërve e ndajnë këtë mendim. 12% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve mendojnë se institucionet

kufizuar kanë treguar se nuk e dinë nëse institucionit arsimore janë të arritshme apo jo, derisa vetëm 1% e prindërve e kanë këtë qëndrim. Lidhur me vetë grupet te personat dhe prindërit me aftësi të kufizuar ekzistojnë variacione të caktuara.


Grafiku 8. Sipas Jush, nëse kopshtet/shkollat janë të arritshme për personat/ fëmijët me handicap dhe në çfarë shkalle ?



arsimore janë pjesërisht të aksesueshme. (Grafiku 8).

Këtë mendim e ndajnë 7.5% e prindërve të fëmijëve me handicap dhe 4.5% e vetë personave me aftësi të kufizuar. 1.5% e personave me aftësi të

18.5% e personave me handicap fizike besojnë se institucionet nuk janë të arritshme, krahasuar me prindërit e fëmijëve me handicap fizike, ku 10.5% mendojnë se nuk janë të arritshëm dhe 1.5% mendojnë se institucionet janë pjesërisht të aksesueshme. 12, 5% e personave



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në arsim


KREU III

me shikim të dëmtuar mendojnë se institucionet nuk janë të arritshme, ndërsa 2% mendojnë se ato janë pjesërisht të aksesueshme. Ky mendim është i ngjashëm edhe me prindërit e fëmijëve me shikim të dëmtuar, ku 1% e tyre mendojnë se institucionet janë pjesërisht të aksesueshme. Personat me dëgjim

të fëmijëve me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folur nuk e dinë nëse institucionet arsimore janë të aksesueshme.

Këto mendime u konfirmuan edhe nga pjesëmarrësit e grupit të fokusit, ku konkluzioni i përgjithshëm është se shkollat fillore dhe të mesme, si dhe fakultetet në Maqedoni, nuk i përmbushin standardet

Grafiku 9. Sipas Jush, a kanë kopshtet/shkollat qasje dhe akses për personat/fëmijët me aftësi të kufizuar dhe deri në çfarë shkalle?



të dëmtuar dhe pengesa gjatë të folurit kanë pikëpamje pothuajse të ngjashme sikurse personat me pamje të dëmtuar. 12% e tyre mendojnë se institucionet nuk janë të arritshme, ndërsa 2% prej tyre kanë treguar se ato janë pjesërisht të aksesueshme. Për dallim nga pikëpamjet e personave me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folur, 1% e prindërve

e aksesueshmërisë. Më shpesh, me qasje pjesëmarrësit nënkuptojnë aksesin fizik, domethënë rampë dhe ashensor, derisa parkingun dhe tualetet e aksesueshme as që i përmendin.

Duke u bazuar në përgjigjet e dhëna nga të anketuarit, mund të vihet në përfundim se ata konsiderojnë se institucionet arsimore nuk janë të qasshme

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në arsim

KREU III

për personat me handicap. Duke qenë se njerëzit me shikim dhe dëgjim të dëmtuar dhe personat me pengesa në të folurit, personat/fëmijët me handicap intelektuale dhe të kombinuara, që realizojnë arsimin e tyre në shkolla speciale, nuk janë të vetëdijshëm për të gjitha elementet e aksesueshmërisë jashtë grupit të tyre në komunitetin me aftësi të kufizuar.

Duke pasur parasysh se arsimi fillor dhe i mesëm është obligues dhe vetëm një numër i vogël i shkollave janë të qasshme, lind pyetja se si dhe në çfarë mënyre fëmijët me handicap mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre për arsim.

Sa i përket qasjes dhe disponueshmërisë së materialeve arsimore (tekstet shkollore, mjetet mësimore etj.), si dhe teknikat edukative, 95.5% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve konsiderojnë se ato nuk janë të përshtatshme, nga të cilët 49% janë persona me handicap, ndërsa 46.5% janë mendime të prindërve të fëmijëve me handicap. Vetëm 4.5% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht, ku 3.5% e prindërve konsiderojnë se materialet arsimore (tekstet shkollore, mjetet mësimore etj.) dhe

teknikat edukative janë të përshtatshme për nxënësit me handicap. Grafiku 10.

Shikuar përmes prizmit të vetë grupeve, (Grafiku 11) mund të vërehet se personat me handicap fizike (1%),

Jam nënë e një vajze 8 vjeçare me zhvillim më të ulët. Kërkova nga shkolla që të përshtatej tavolina, karrigia dhe tualeti që vajza ime të ndiqte mësimin, por më refuzoi drejtori i shkollës me konstatimin se “tani për një fëmijë unë do të duhet të rinovoj ...”

Deklarata e një pjesëmarrësi nga fokus grupi

prindërit e fëmijëve me handicap fizike (2.5%), si dhe me % shumë të vogël të prindërve të fëmijëve me shikim të dëmtuar dhe prindërit e fëmijëve me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folurit kanë mendimin se materialet janë të përshtatshme për personat me handicap.




HALLKA QË MUNGON


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

KREU III

Grafiku 10. Nëse materialet arsimore (librat, pajisjet ndihmëse mësimore dhe ngjashëm) dhe teknikat edukative janë të përshtatshme për nxënësit me handicap?



Grafiku 11. Nëse materialet arsimore (librat, pajisjet ndihmëse mësimore dhe ngjashëm) dhe teknikat edukative janë të përshtatshme për nxënësit me handicap?



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

KREU III


Këto mendime janë konfirmuar edhe nga pjesëmarrësit e grupit të fokusit, ku konkluzioni i përgjithshëm është se ato nuk janë të pajisura në mënyrë adekuate teknikisht dhe materialisht, fëmijët me nevoja të veçanta mësojnë në bazë të përmbajtjeve të papërshtatshme dhe të pa harmonizuara mësimore që nuk janë në gjendje t'i zotërojnë dhe nuk ka të tekste të veçanta shkollore që do të lehtësonin edukimin e kësaj kategorie fëmijësh.

Krahas qasjes në shkollat fillore dhe të mesme, 72,5% e të anketuarve në pyetjen: “Nëse personat me aftësi të kufizuara kanë mundësinë që të kenë qasje në arsimin sipëror, trajnim profesional, arsim për të rritur dhe mësim të përjetshëm pa diskriminim dhe në bazë të barabartë me të tjerët?” konsiderojnë se nuk kanë mundësi të barabarta që të kenë qasje deri në ato institucione.

“Nëna ime më përshkruante mësimet me shkronja më të mëdha që të mund të mësoj. Provuam që të më lexojë me zë, por nuk munda që të koncentrohem ashtu”, deklarata e një pjesëmarrësi të grupit të fokusit.

“Studenti me aftësi intelektuale të kufizuara lexon, shkruan dhe mëson ngadalë. Asistenti më tha se jam përtac, ndërsa unë kam nevojë për më shumë kohë që të mësoj materialin dhe më shumë kohë gjatë dhënies së kollokuimit ose provimit. Mësoja me motrën time, e cila mi ndante leksionet në paragrafë më të vogël sepse ashtu më lehtë koncentrohem dhe më lehtë mësoj. Gjatë studimeve asistentët dhe profesorët e kanë kuptuar atë dhe më mundësuan që të përgjigjem me gojë ose më japin më shumë kohë gjatë provimit me shkrim”, u shpreh një student nga grupi i fokusit.

Tekstet shkollore, lekturat dhe librat e ngjashme nuk janë të qasshme në formate të përshtatshme për të verbrit ose fëmijët me shikim të dobët. “Të gjitha librat dhe lekturat ia shkruaj në font më të madh që të mund t'i lexojë”, u shpreh një prind i fëmijës me aftësi të kufizuara.




HALLKA QË MUNGON


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

Grafiku 12. A kanë personat me handicap mundësinë për të hyrë në arsimin e lartë, trajnimin profesional, arsimin e të rriturve dhe në të mësuarit e përgjithshëm pa diskriminim dhe në mënyrë të barabartë me të tjerët?



Grafiku 13. A e kanë mundësinë personat me handicap për të hyrë në arsimin e lartë, trajnimin profesional, arsimin për të rritur dhe të mësuarit e përgjithshëm pa diskriminim dhe në mënyrë të barabartë me të tjerët?



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III


Nga 72% e të anketuarve, 42% e të anketuarve janë persona me handicap, ndërsa 30.5% janë prindër të fëmijëve me handicap. 19.5% e të anketuarve – prindër të fëmijëve me handicap nuk e dinë nëse fëmijët/personat me handicap mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për arsim të lartë, trajnimin profesional, arsimim për të rritur dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës pa diskriminim dhe në mënyrë të barabartë me të tjerët, që është fakt mjaft shqetësues. Grafiku 13

Nga të dhënat në këtë grafik mund të konstatohet se prindërit e fëmijëve me handicap nuk kanë njohuri për mundësitë

dhe të drejtat që i kanë apo nuk i kanë personat me handicap kur janë të rritur.

Në pyetjen “Nëse gjatë procesit arsimor ju është siguruar juve/fëmijës tuaj adaptim i duhur?”, 61.5% e të anketuarve janë përgjigjur negativisht (Grafiku 14), nga të cilët 35% janë persona me handicap dhe 26.5% janë prindër të fëmijëve me handicap. Vetëm 1.5% e të anketuarve – prindër të fëmijëve me handicap janë përgjigjur pozitivisht, respektivisht gjatë procesit arsimor u është siguruar përshtatje e duhur fëmijëve të tyre me handicap.

Grafiku 14. Nëse gjatë procesit arsimor ju është siguruar juve/fëmijës tuaj adaptim i duhur?





HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

“Fakulteti im është i kalueshëm. Vetëm një shkallë është jashtë dhe babai im duhet të më ndihmojë këtu”, deklaratë e një personi me handicap.

“Nëna ime ose gjyshja ime më shoqërojnë në fakultet për të kaluar shkallët. Përndryshe unë mundem vetë. Ndonjëherë edhe kolegët po më ndihmojnë”, deklaratë e vajze me handicap.

“Nxënësit dhe studentët shkojnë në shkollë/universitet me të afërmit e tyre, më shpesh me prind”, deklaratë nga një përfaqësues i institucioneve.

Përqindja është shumë e lartë e të anketuarve që nuk kanë dhënë një përgjigje. Nga 37% e të anketuarve, 22% janë prindër të fëmijëve me handicap, ndërsa 15% janë persona me handicap. Vëzhguar përmes vetë grupeve, mund të vërehet se përshtatje adekuate iu është ofruar prindërve me handicap fizike (1%) dhe prindërve të fëmijëve me shikim të dëmtuar (0.5%).

Në Grafikon 15 mund të shihet se personat dhe prindërit e fëmijëve me handicap nuk e njohin mjaftueshëm institutin për adaptimin adekuat. Në anketim ka gjithashtu një përqindje të lartë të të anketuarve që nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, ku përqindja më e madhe paraqitet te prindërit e fëmijëve me handicap intelektuale (9.5%), pastaj te prindërit e fëmijëve me handicap të kombinuara (4.5%), pasuar nga prindërit e fëmijëve me handicap fizike (4%). Në të anketuarit me handicap niveli më i lartë i që nuk e njohin Institutin e adaptimit adekuat është në mesin e personave me handicap me shikim të dëmtuar (5%) dhe te personat me aftësi të kufizuara fizike (4%).

Në pyetjen: “A ndihmon sistemi arsimor në zhvillimin e personalitetit, talenteve, kreativitetit dhe aftësitë e nxënësve/fëmijëve me handicap?”, 19% e të anketuarve konsiderojnë se sistemi arsimor ndihmon pjesërisht në zhvillimin e talenteve, kreativitetit dhe aftësive të personave me handicap.


81% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve konsiderojnë se sistemi arsimor nuk ndihmon në zhvillimin e personalitetit, talenteve, kreativitetit dhe

HALLKA QË MUNGON


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim


KREU III

Grafiku 15. Nëse gjatë procesit arsimor ju është siguruar juve/fëmijës tuaj adaptim i duhur?



Grafiku 16. A ndihmon sistemi arsimor në zhvillimin e personalitetit, talenteve, kreativitetit dhe aftësitë e nxënësve/fëmijëve me handicap?





HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III


aftësive të nxënësve/fëmijëve me handicap. Këtë mendim e ndajnë 47% e të anketuarve që janë persona me handicap.

Në këto të dhëna, prindërit e fëmijëve me handicap kanë më pak mendim negativ në qasjen e sistemit arsimor në zhvillimin e personalitetit, talenteve, kreativitetit dhe aftësive të nxënësve/fëmijëve me handicap - 34%. Është interesant fakti që konsideratat për zhvillimin e pjesëshëm është më i shprehur te prindërit e fëmijëve me handicap fizike

(4.5%) dhe te prindërit e fëmijëve me shikim të dëmtuar (1.5%).

Derisa te personat me handicap ky mendim është më i lartë te personat shikim të dëmtuar (2%) dhe te personat me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folurit. Përgjigja më e madhe negative në komunitet është për personat me handicap fizike (18%), ndërsa te prindërit – te prindërit e fëmijëve me handicap fizike (7.5%). Grafiku 17..

Графикон 17. Дали образовниот систем помага за развој на личнoста, талентите, креативноста и способностите на учениците/децата со хендикеп?



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III


Me qëllim që fëmijët me handicap të kenë qasje të lirë deri te institucionet arsimore, tërësisht të marrin pjesë në aktivitetet arsimore dhe të rrisin nivelin e arritjes së tyre arsimore, duhet të përbushen katër parakushtet në vijim: 1) aftësim të rrethinës fizike, siç janë dyert, korridorët, ashensorët dhe barrikatadat e shkollave, si dhe të siguruarit e programeve dhe materialeve mësimore dhe të pajisjeve; 2) trajnime dhe aktivitete të tjera për përfundimin e kapaciteteve të kuadrit mësimor dhe të punësuarve në shkolla; 3) ngritje të vetëdijes tek nxënësit, kuadri mësimor dhe personelit tjetër të punësuar për nevojat dhe kushtet në të cilat jetojnë personat me handicap; dhe 4) të siguruarit e sistemeve për mbështetje dhe ndihmë.

Në atë drejtim, në pyetjen (Grafiku 18) “Nëse shkollat/kopshtet kanë kuadër të trajnuar mësimor për punë me nxënësit/fëmijët me handicap?” 64,5 % e të anketuarve kanë bërë me dije se institucionet nuk kanë kuadër të trajnuar. Këtë mendim e ndajnë 40% e të anketuarve me handicap, ndërsa shumë më e vogël është përqindja tek prindërit e fëmijëve me handicap (24,5%). 27,5 % e të anketuarve megjithatë konsiderojnë se ka kuadër të trajnuar mësimor në institucio-

“Përfshirja është punë e mirë vetëm për ata me aftësi të lehta fizike dhe mentale të kufizuara. Me ata që janë në gjendje më të rëndë nuk mund të punohet gjatë mësimin të rregullt. Kjo merr kohën që duhet t’u përkushtohet gjithë nxënësve. Madje edhe vetëm një shkronjë po të mësohet, fëmijët e tjerë shkojnë para. Kjo nuk është mirë edhe për vet fëmijën, sepse do të ndjejë veten më pak të vlefshëm...”, deklaroi një pjesëmarrës nga grupi i fokusit.

“Unë kam pengesa me të dëgjuarit. Jam artist pa diplomë. Kam mbaruar për bravapunues, sepse vetëm atë e ofron shteti në shkollën e mesme speciale. Doja të regjistrohesha në art, por nuk kishte mundësi – isha i shurdhër”, deklaroi një pjesëmarrës i grupit të fokusit.

net arsimore, por është i pamjaftueshëm. Edhe te ky mendim ekziston dallimi i madh mes personave me handicap në krahasim me prindërit me handicap, ku 21% e prindërve konsiderojnë se ka



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim


KREU III

kuadër, ndërsa ky mendim te personat me handicap është 6,5 %.


Duke u nisur nga vetë grupet, mund të vërehet se përgjigjet negative janë më të

mëdha në mesin e personave me handicap fizike (16%), pasuar nga personat me shikim të dëmtuar (12%) dhe personat me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folurit (10,5 %).

Grafiku 18. Nëse shkollat/kopshtet kanë kuadër të trajnuar për punë me nxënësit/fëmijët me handicap?



Grafiku 19. Nëse shkollat/kopshtet kanë kuadër të trajnuar për punë me nxënësit/fëmijët me handicap?



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

Tek prindërit opinioni negativ kryesisht shprehet nga prindërit e fëmijëve me handicap fizike (7%), ndërsa pastaj nga prindërit e fëmijëve me handicap intelektuale (9%). Mendimet e këtilla janë gjithashtu një tregues i mjaftueshëm që shteti duhet, megjithatë, të marrë masa për të punësuar kuadër arsimor, duke përfshirë edhe mësimdhënës me aftësi të kufizuar të cilët janë të kualifikuar për gjuhën e shenjave dhe/ose alfabetin Braj, dhe të ofrojë trajnime për stafin mësimdhënës që punon në të gjitha nivelet e arsimit.

Sistemi arsimor si një bazë duhet të ketë supozimin se të gjithë fëmijët mund të mësojnë dhe të kenë potencial për t'u arsimuar. Kjo nënkupton zhvillimin e pritjeve të larta në aspektin e rezultateve të mësimin për të gjithë fëmijët. Kjo gjithashtu do të thotë se sistemi duhet të identifikojë nevojat specifike të mësuarit të fëmijëve të ndryshëm dhe për të përshtatur praktikën e mësimdhënies në rrethanat specifike për të përmbushur këto nevoja dhe për të siguruar të gjithë fëmijëve mundësi të përshtatshme për të mësuar në shkollë, si dhe jashtë saj. Shkurtimisht, ky parim do të thotë se shtetet duhet të marrin parasysh që rrethanat ekonomike, so-

“Përfshirja e fëmijëve të shurdhër në sistemin arsimor nuk është realizuar, dhe kryesisht varet nga vullneti i individëve, mësimdhënësve apo stafit tjetër, ku atyre nuk u punohet dhe puna e tyre nuk vlerësohet. Studimi i gjuhës së gjesteve në arsim duhet të bëhet lëndë e detyrueshme. Për të shurdhrit, gjuha amtare është gjuha e gjesteve. Nxënësit e shurdhër nuk lejohen të interpretojnë gjuhën e gjesteve”, deklarata e një prej pjesëmarrësve të grupit të fokusit.

ciale, kulturore apo personale të mos shndërrohen në burime të diskriminimit që do të parandalojnë disa fëmijë që të kenë përvojë cilësore të të mësuarit mbi baza të barabarta me të tjerët.

Në këtë drejtim është edhe nevoja e të siguruarit të mbështetjes së nevojshme në kuadër të sistemit arsimor, ku 98% e të anketuarve konsiderojnë se në sistemin arsimor nuk janë në dispozicion sistemet për mbështetje të nxënësve me handicap që synojnë fitimin arsimin




HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim


KREU III

efektiv. (Grafiku nr. 20). Këtë mendim e ndajnë 49.5% e personave me aftësi të kufizuar, ndryshe nga prindërit e fëmijëve me handicap, ku 48.5% janë shprehur se në sistemin arsimor nuk janë në dispozicion sistemet për mbështetje të nxënësve me handicap që synojnë fitimin arsimin efektiv.

Grafiku 20. Nëse në sistemin arsimor janë në dispozicion sistemet për përkrahjen e nxënësve me handicap që kanë për qëllim përvetësimin e arsimimit efikas?



Grafiku 21. Nëse në sistemin arsimor janë në dispozicion sistemet për përkrahjen e nxënësve me handicap që kanë për qëllim përvetësimin e arsimimit efikas?



HALLKA QË MUNGON


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III


Lidhur me këtë pyetje, nuk ka ndryshime të mëdha në të gjitha grupet e komunitetit. Pa dyshim edhe personat me handicap dhe prindërit e fëmijëve me handicap janë në të njëjtën linjë sa i përket pamundësisë së mbështetjes nga shteti.


Në Grafikon 22 mund të shihet se 53.5% e të anketuarve konsiderojnë se puna e institucioneve arsimore nuk është e mirë, 27% janë deklaruar se nuk u pëlqen fare, ndërsa 19.5% e kanë ndjesinë se nuk është ajo që nevojitet.

Grafiku 22. Si e vlerësoni punën e institucioneve arsimore lidhur me personat me handicap?



Grafiku 23. Si e vlerësoni punën e institucioneve arsimore lidhur me personat me handicap?






HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

Me vlerësimin “nuk është e mirë” janë deklaruar 27 % e të anketuarve me handicap dhe 26.5% e prindërve. Përqindja se nuk u pëlqen fare puna e institucioneve arsimore lidhur me personat me handicap është më shumë e shprehur te të anketuarit me handicap (17.5%) në krahasim me prindërit e fëmijëve me handicap (10%). 13.5% e prindërve kanë “ndjesinë se nuk është ajo që duhet të jetë” që është 6.5% më e madhe se mendimi i të anketuarve me handicap (6%).

Grafiku 24. Çfarë do t’u kishit propozuar shkollave/kopshteve për t’u përmirësuar inkluziviteti i fëmijëve me handicap në procesin mësimor të rregullt?



Për qindja më e madhe e përgjigjeve se nuk është e mirë puna e institucioneve arsimore në lidhje me personat me handicap është shprehur nga personat me handicap fizike (11.5%) dhe te prindërit e fëmijëve me handicap intelektuale (9.5%). Grafiku 23

Të anketuarve u ofruam 7 përgjigjeve dhe ata të zgjedhin se çfarë do t’u kishin propozuar shkollave/kopshteve që të përmirësohet inkluziviteti i fëmijëve me handicap në procesin e rregullt mësimor.

Nga propozimet e dhëna (Grafiku 24) 86% e të anketuarve kanë treguar se është e nevojshme të ofrohen materiale arsimore të qasshme dhe të arritshme për fëmijët me handicap, ndërsa 72.5% e të anketuarve mendojnë se nevojitet trajnim i detyrueshëm për stafin ekzistues arsimor për të punuar me fëmijët me handicap të llojllojshme dhe përfshirjen e detyrueshme të çështjes së aftësisë së kufizuar në programet arsimore.

Vetëm 47% e të anketuarve vunë në dukje krijimin e një ekipi të veçantë për të punuar me fëmijët me handicap. 39% e të anketuarve theksuan planet individuale, ndërsa vetëm 30,5% do të kishin ofruar trajnime për kuadrin mësimor të gjuhës së shenjave.

Bazuar në përgjigjet e theksuara, dallimet kryesore mund të vërehen te personat dhe prindërit e fëmijëve me handicap. Derisa 39% e prindërve do të propozonin krijimin e ekipeve speciale për të punuar me personat me handicap, këtë do ta kishin propozuar vetëm 8% e personave me handicap.

Gjithashtu, 39% e prindërve do të propozonin zhvillimin e planeve individuale, ndërsa personat me handicap nuk do ta kishin sugjeruar fare

HALLKA QË MUNGON


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

“Mësimdhënësit nuk janë të trajnuar mjaftueshëm për të punuar me fëmijët me handicap: arsimi inkluziv nuk është studiuar në masën e duhur në fakultetet pedagogjike. Mundësitë në dispozicion për zhvillimin profesional të mësimdhënësve janë iniciativa të sektorit civil, por janë zgjidhur në mënyrë sistematike”, deklarati nga një pjesëmarrës i grupit të fokusit.

atë. Ka edhe ndryshime të mëdha edhe në propozim-masat për përfshirjen e çështjes së aftësisë së kufizuar në programet arsimore ku 40.5% të personave me handicap do ta kishin propozuar këtë masë, për dallim nga prindërit (32%).

Situata është e ngjashme me aplikimin e trajnimit të detyrueshëm për kuadrin ekzistues, ku 38.5% e personave me handicap do ta kishin propozuar atë si një masë, për dallim nga prindërit ku vetëm 34% e të anketuarve do ta kishin propozuar këtë masë.




HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

Grafiku 25. Çfarë do t'u kishit propozuar shkollave/kopshteve për t'u përmirësuar inkluziviteti i fëmijëve me handicap në procesin mësimor të rregullt?



Për shkak të ndryshimeve të mëdha në masa të caktuara, rezultati është që personat me handicap nuk janë të përfshirë në mënyrë aktive në procese të caktuara të iniciuara nga shteti dhe prindërit e fëmijëve me handicap. Kjo mund të shihet qartë edhe nga përqindja e dalluar tek individët dhe prindërit e fëmijëve me handicap për zhvillimin e planeve individuale ose inkorporimin e ekipeve

speciale për të punuar me fëmijët me handicap në arsim.

Prandaj është e nevojshme që shteti dhe institucionet arsimore të përfshijnë personat me handicap, duke përfshirë edhe fëmijët me handicap intelektuale, në krijimin e të gjitha programeve, masave ose propozim aktivitetëve, edhe nëse janë ato të kota dhe të thjeshta, në të siguruarit e arsimit gjithëpërfshirës.

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

Në pyetjen “Çfarë lloj shkolle duhet të ndjekin personat me handicap?” 61% e të anketuarve janë përgjigjur se ai duhet të jetë arsim i rregullt, ndërsa 39% konsiderojnë se ajo duhet të ndodhë në shkolle speciale. Për shkolla speciale, krahasuar me 28.5% të prindërve me fëmijë me handicap. 39.5% e personave me handicap janë për arsimim të rregullt, ndërsa 28.5% janë prindër të fëmijëve me handicap.

Tabela 10: Çfarë kategoritë e personave me handicap do t'u kishin propozuar shkollave/kopshte për t'u përmirësuar inkluziviteti i fëmijëve me handicap në procesin mësimor të rregullt?

Çfarë do t'u kishit propozuar shkollave/kopshteve për t'u përmirësuar inkluziviteti i fëmijëve me handicap në procesin mësimor të rregullt?	Persona me handicap fizike	Persona me shikim të dëmtuar	Persona me dëgjim të dëmtuar	Persona me handicap intelektuale	Prindër të fëmijëve me handicap fizike	Prindër të fëmijëve me shikim të dëmtuar	Prindër të fëmijëve me dëgjim të dëmtuar	Prindër të fëmijëve me handicap kombinuar	Prindër të fëmijëve me handicap intelektuale
Përfshirjen obligative të çështjes së aftësisë të kufizuara në plan-programet mësimore	13,5%	14,0%	11,5%	1,5%	7,5%	2,5%	4,5%	9,0%	8,5%
Trajnim për kuadrin ekzistues për punë me fëmijë lloje të ndryshme të aftësisë të kufizuara	15,5%	12,5%	8,0%	2,5%	4,5%	2,5%	3,5%	8,0%	15,5%
Trajnim për kuadrin mësimor për njohjen e gjuhës së shenjave	5,0%	0,0%	14,5%	0,0%	0,0%	0,0%	6,0%	5,0%	0,0%
Formimin e ekipit special për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara	0,0%	5,0%	1,5%	1,5%	4,5%	2,5%	5,5%	10,5%	16,0%
Akses dhe qasje të materialit mësimor për fëmijët me aftësi të kufizuara	14,5%	9,0%	14,0%	2,0%	8,5%	3,5%	6,0%	10,5%	18,0%
Inkuadrin e teknologjisë ndihmëse në procesin arsimor	12,5%	10,0%	5,5%	2,5%	8,0%	3,5%	1,0%	6,0%	10,5%
Përpilim të planeve arsimore individuale, duke i marrë parasysh aftësitë e nxënësit/fëmijës me aftësi të kufizuara	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	8,5%	3,5%	1,0%	10,0%	16,0%

Edhe te kjo pyetje ka variacione të ndryshme midis prindërve dhe personave me aftësi të kufizuara. Në fakt, 10.5% e personave me handicap janë

Nëse shikojmë Grafikon 27 do të shohim se 12.5% e prindërve të fëmijëve me handicap intelektuale janë për shkolla speciale. Madje 3% e prindërve



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim


KREU III

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

KREU III

Grafiku 26. Çfarë shkolla duhet të ndjekin nxënësit me handicap?



të fëmijëve me handicap fizike konsiderojnë se fëmijët e tyre duhet të shkojnë në një shkollë speciale. Ndryshe nga prindërit, te personat me handicap përqindja është si në vijim: 1% e personave me handicap intelektuale, 4.5% tek personat që kanë problem me dëgjimin dhe pengesa në të folurit dhe 5% e personave me shikim të dëmtuar.

Qëndrimet e këtilla janë një tregues shtesë se që nga ratifikimi i Konventës për të Drejtat e Personave me Handikap, shteti nuk ka punuar për të ngritur ndërgjegjësimin e opinionit, si te publiku i gjerë, prindërit, ashtu edhe te vet personat me handicap.

Përfshirja në arsimin e rregullt është e rëndësishme jo vetëm për shkak se ajo

siguron mjedisin më të mirë arsimor për nxënësit me handicap, por për shkak se ajo ndihmon edhe në ballafaqimin me stereotipat dhe paragjykimet që kanë nxënësit tjerë pa handicap dhe publiku i gjerë për personat me handicap, ashtu edhe në tejkalimin e tyre.

Qëllimi i arsimimit special do të jetë vetëm për të përgatitur nxënësit për përfshirje në procesin e rregullt arsimor në ndonjë instancë të ardhshme e jo të bëhen institucione të tyre arsimore.


“Pse persona që kanë problem me të dëgjuarin të shkojnë në arsim të rregullt - Ejani Ju në shkollë të mesme për të shurdhër, si do të kuptoheni ju me ne” - deklaratë e një pjesëmarrësi të grupit të fokusit.

“Prindërit e fëmijëve me handicap nuk duhet të mohojnë se ata kanë një fëmijë me handicap, sepse kur të regjistrohet fëmija në arsimin e rregullt do të mungojnë rezultatet për shkak të asaj. Në testimin ekstern nuk lejohet shoqërimi”, deklaratë e një pjesëmarrësi të grupit të fokusit.

“Në dekadën e fundit arsimit i mesëm është i detyrueshëm, por qasja nuk është përmirësuar fare. Fakti që arsimi i mesëm është bërë i detyrueshëm duhet të nënkuptojë një detyrim për shtetin që të ofrojë arsim të mesëm gjithëpërfshirës. Nuk duhet punët të varen nga ajo që çfarë personaliteti është drejtori i shkollës”, deklaratë e një pjesëmarrësi të grupit të fokusit.

“Notimi i nxënësve me handicap që përcjellin një plan edukimi individual nuk është zgjidhur. Mësuesit kanë dilema se si të veprojnë, ku në shumicën e rasteve ‘bëjnë lëshime’, por ai është një reflektim i pritjeve të tyre të ulëta”, deklaratë e një pjesëmarrësi të grupit të fokusit.

Grafiku 27. Çfarë shkolla duhet të ndjekin nxënësit me handicap?



Konkluzione dhe rekomandime




HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

Konkluzione

- Përkundër ekzistimit të standardeve fort të bazuara ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin dhe detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar KDPH, legjislacioni nacional ende lë vend për paqartësi në lidhje me ndalimin e ndarjes së shkollës mbi bazën e aftësisë së kufizuar.
- Legjislacioni në fushën e arsimit nuk ofron një qasje sistematike dhe të rumbullakosur për realizimin e së drejtës për arsimim të personave me aftësi të kufizuar pa diskriminim dhe në baza të barabarta me të tjerët, në pajtim me Konventën për të drejtat e personave me handicap dhe, gjithashtu, nuk ka sanksione efektive në rastin e segregimit shkollor ndaj nxënësve me handicap.
- Institucionet arsimore nuk kanë obligim për aftësim përkatës dhe të njëjtat nuk janë përgjegjëse për mosrealizimin e pajustificuar të së njëjtës, që është një pengesë serioze në luftën kundër diskriminimit ndaj personave me handicap dhe krijimin e mundësive të barabarta. Sipas hulumtimit 85.5% të personave me handicap dhe prindërve të fëmijëve me handicap besojnë se shkollat nuk janë përgjithësisht të qasshme për personat me handicap, 86% e të anketuarve treguan se materialet arsimore duhet të jenë të qasshme.
- Sistemi ekzistues i arsimit të lartë, trajnimi i vokacioneve, arsimiti i të rriturve dhe të mësuarit e përjetshëm nuk përfshijnë çështjen e aftësisë së kufizuar dhe nuk ofrojnë mundësi për përfshirje më aktive të personave me handicap. Sipas anketës 72.5% e të anketuarve (personat me handicap dhe prindërit e fëmijëve me handicap) besojnë se ata nuk kanë mundësi të barabarta për qasje në arsimin e lartë, formimin profesional, arsimimin e të rriturve dhe të mësuarit e përjetshëm pa diskriminim mbi baza të barabarta me të tjerët.





HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

Konkluzione

- Institucionet shpesh marrin vendime për planifikimin e arsimit pa pasur përfshirjen sociale si qëllim dhe pa përfshirjen e organizatave të personave me handicap, vetë fëmijët dhe nxënësit me handicap. Për shembull, vendimi për të hapur ose për të mbajtur shkolla të caktuara apo vendimet për të hapur klasa të reja në shkollat e caktuara shpesh sillen pa marrë parasysh nevojat e fëmijëve me handicap në arsimin gjithëpërfshirës. Sipas sondazhit 42% e personave dhe prindërve me handicap besojnë se duhet të ketë ekipe të veçanta për të punuar me persona/fëmijë me handicap në sistemin arsimor, 39% e prindërve të fëmijëve me handicap besojnë se duhet të kenë plane individuale, ndërkohë që personat me handicap konsiderojnë se nuk ka nevojë për ato.
- Mësimdhënësit shpesh ndihen të përgatitur në mënyrë joadekuate për të mësuar fëmijët me handicap. Kompetencat e nevojshme për praktikën efektive nuk zhvillohen në mënyrë sistematike dhe nuk ofrohet mbështetje adekuate në sistemin arsimor.
- Ekzistimi i sistemit segregues të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar nuk ofron kualitet më të lartë të arsimit dhe ulje të animozitetit ndaj fëmijëve me handicap dhe më tej, e njëjta nuk mundëson zhvillimin e kapaciteteve individuale, talenteve dhe aftësive të personave me handicap. Sipas anketës, 61% e të anketuarve besojnë se nxënësit me handicap duhet të shkojnë në arsim të rregullt.
- Mosndërmarrja e masave për të siguruar cilësinë e arsimit në të gjitha shkollat në mënyrë të barabartë ushqen rrethim vicioz të cilësisë më të ulët të arsimit, veçanërisht në klasa të veçanta dhe speciale për fëmijët me handicap, pas çka sistemi arsimor ka pritshmëri të ulëta ose asnjë lloj pritshmërie nga fëmijët me handicap.
- Një nga barrierat kryesore në diskriminim ndaj fëmijëve me handicap në sistemin arsimor është mungesa e një vetëdije kolektive për rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës për kohezionin social dhe krijimin e një shoqërie, ku fëmijët dhe nxënësit me handicap do të kenë mundësi të barabarta.

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

Konkluzione

- Personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat e personave me handicap nuk janë të përfshirë në mënyrë aktive në krijimin e sistemit arsimor, si dhe as në politikat dhe projektet të cilat janë ngritur në këtë fushë.
- Vlerësimi i hyrjes së fëmijëve me handicap në sistemin arsimor bëhet në baza mjekësore-defektologjike që paraqet një pengesë serioze për përfshirje më aktive të personave me handicap në sistemin arsimor në të gjitha nivelet.
- Institucionet arsimore në të gjitha nivelet nuk nxisin përfshirjen e kadrove me handicap në hartimin e politikave, si dhe në përfshirjen aktive të organizatave të personave me handicap, individëve me aftësi të kufizuar ose fëmijëve me handicap.
- Praktika tregon se shteti nuk ndërmerr përpjekje të mjaftueshme për të zbatuar plotësisht detyrimet e ndërmarra me ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Handikap dhe nevojitet përmirësim i konsiderueshëm, në mënyrë që të realizohen në mënyrë efektive të drejtat e personave me handicap.
- Nga rezultatet e hulumtimit konstatohet se shumica e personave me aftësi të kufizuar dhe prindërve të fëmijëve me handicap nuk i njohin të drejtat e tyre/ të drejtat e fëmijëve të tyre me handicap, ndaj interpretimin e tyre më së shpeshti e lidhin me qasjen mjekësore të shikimit të situatës së aftësisë së kufizuar. Po kështu, edhe personat me handicap dhe prindërit e fëmijëve me handicap kanë një nivel të ulët të njohurive rreth infrastrukturës ekzistuese institucionale për të drejtat e tyre.



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

Rekomandime

- Legjislacioni kombëtar në sferën e arsimit duhet tërësisht të reformohet në drejtim të përputhjes së tërësishme me Konventën për të Drejtat e Personave me Handikap dhe të vlejë si për institucionet arsimore publike, ashtu edhe për ato private.
- Ndalimi i diskriminimit si dhe përshtatja e duhur në bazë të aftësive të kufizuara në të gjitha nivelet duhet qartë të përcaktohet në kornizën ligjore dhe pastaj e njëjta të vlejë për regjistrimin dhe kushtet për regjistrim të nxënësve në institutin arsimor adekuat; qasja e nxënësve për cilëndo lëndë mësimore, institucion ose interes të cilin e ofron instituti arsimor; ose çregjistrimin e nxënësit nga instituti arsimor; ose çfarëdo sanksioni tjetër i ndërmarrë kundër nxënësit.
- Me rëndësi të madhe është të përpunohet sistemi gjithëpërfshirës i vlerësimit të nevojave arsimore të nxënësve me handicap. Ky sistem duhet të jetë i pavarur nga shkollat, ndërsa puna e tij duhet të përcillet me kujdes dhe rregullisht nga ana e shtetit, ku do të jenë të përfshira kuadro dhe profesionistë me handicap. Planet arsimore individuale për personat me handicap duhet të jenë të përshtatura dhe të krijuara në pajtim me nevojat e fëmijës dhe me përfshirjen aktive të personave dhe fëmijëve me handicap në të gjitha proceset.
- Është e nevojshme reforme urgjente e programeve mësimore, ku qartë do të përcaktohet detyra për përpunimin e tyre në formate të arritshme, si dhe hyrje e detyrueshme e lëndës për çështjen e aftësive të kufizuara, ndërsa në Fakultetin Pedagogjik do të ishin krijuar profile të reja për mbështetje dhe punë me nxënësit me handicap, si për shembull asistentë arsimorë.
- Duhet të ripërcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e profesionistëve të shërbimeve profesionale të shkollës me qëllim të sigurohet mbështetje adekuate për mësimdhënësit dhe nxënësit. Vendi i tyre është në klasë, ku do të marrin pjesë në mënyrë aktive për mësimin e nxënësve.

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

Препораки

- Nevojitet reformë urgjente të ligjit për tekstet shkollore, me përcaktim të qartë të detyrës për përpunimin e tyre në formate të arritshme.
- Është i nevojshëm një kuadër rregullator adekuat që të mënjanohet përqendrimi i lartë i nxënësve me handicap në shkollat speciale, si dhe masa me të cilat disa nga këto shkolla do të mbyllen, ndërsa disa do të ishin të reformuara në qendra tranzicioni nga arsimi special në arsim të rregullt.
- Janë të nevojshme politika aktive që të përcaktohen nevojat arsimore dhe të mundësohet përfshirje të nxënësve me handicap të cilët më vonë janë të përfshirë në sistemin e arsimit, veçanërisht personat e rritur me aftësi të kufizuara të cilët, për shkak të një numri të caktuar rrethanash, nuk kanë qenë të përfshirë në arsim. Gjithashtu, janë të domosdoshme edhe masat për përfshirje të nxënësve me handicap, që janë të vendosur në institucione dhe objekte shëndetësore.
- Është i nevojshëm zhvillimi i shërbimeve për mbështetje të institucioneve arsimore me përfshirje aktive të personave me handicap.
- Është i nevojshëm një ndryshim ligjor dhe struktural në Qendrën për Arsim Profesional, ku do të përfshihen kuadro me handicap.
- Që legjislacioni të ketë efektin e dëshiruar për këtë grup të banorëve, i njëjti duhet të jetë i shoqëruar me masa tjera shtesë, si për shembull ngritja e vetëdijes, ndërtim të kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse dhe analizë detale të legjislacionit dhe politikave dhe promovimin e tyre të duhur.
- Ndryshim dhe njohje të gjuhës së gjesteve si gjuhë zyrtare dhe obligim për mësimin e saj në shkolla.
- Marrje e masave dhe politikave për fushata të vazhdueshme për ndryshimin e mentalitetit në nivel të shoqërisë. Me rëndësi të madhe është shoqëria në tërësi, bartësit e vendimeve dhe të gjithë pjesëtarët të përfshirë në fushën e arsimit ta kuptojnë tërësisht nevojën e ndryshimit të kësaj paradigme.



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

Rekomandime

- Inkorporimi i detyrimit për përfshirje të obligueshme të organizatave të personave me handikap dhe individualëve me handikap, si dhe vetë fëmijët me handikap, pastaj duke marrë parasysh të gjithë format e aftësive të kufizuara dhe bilancin gjinor, në krijimin e të gjitha programeve, masave ose propozim aktivitetet, pa marrë parasysh nëse janë më të thjeshta dhe më të zakonshme në procesin e sigurimit të arsimit gjithëpërfshirës.
- Ngritja e vetëdijes te personat me handikap dhe prindërit e fëmijëve me handikap për Konventën për të Drejtat e Personave me Handikap, të drejtat e tyre dhe përgjegjësitë e shtetit të marra me ratifikim të Konventës.
- Nga të dhënat e hulumtimit rekomandohet që është e nevojshme rritja e kapacitetit dhe organizatave të personave me handikap për përfaqësim dhe përfshirje në miratimin e politikave që i kanë të bëjnë me personat me handikap.

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

Bibliografia

Rezolutë e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 13 Dhjetor të vitit 2006, 24 janar të vitit 2007. Në dispozicion në: https://treaties.un.org/doc/source/docs/A_RES_61_106-E.pdf >

Statusi i nënshkrimit dhe ratifikimit të KDPH. Në dispozicion në: <http://treaties.un.org/Pages/VieëDetails.aspx?src=TREATY &mtdsg_no=IV-15&chapter=4&lang=en>


Ligji për ratifikimin e Konventës për të drejtat e personave me invaliditet dhe Protokollin fakultativ të Konventës për të Drejtat e Personave me Handikap, Kuvendi i RM-së, viti 2011, faqe 19, në dispozicion në: <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/ED1FF6FC1C8A1F4A8F36F48EFDE95E55.pdf>>

Publikimi: “Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, me amendamentet e kushtetutës I – XXXII“, NP Gazeta Zyrtare e RM-së, faqe 55, edicioni 55, në dispozicion në: <<http://www.slvesnik.com.mk/content/Ustav%20na%20RM%20-%20makedonski%20-%20FINALEN%202011.pdf>>

“Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm deri më 2030” – objektivi 4. Në dispozicion në: <<https://www.un.org/sustainabledevelopment/education/>>

“Studim tematik për të drejtën e personave me handikap në arsimim. Raporti i Zyrës së Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të OKB, A/HRC/25/29 and Corr.1, paragrafi 3 dhe 68. Në dispozicion në: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session25/Documents/A-HRC-25-29_en.doc>

“Koment i përgjithshëm nr. 13 (1999), Neni 13: E drejta e arsimit” – neni 13 (2) E drejta e arsimit, faqe 3 OKB Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Në dispozicion në: <<http://www.refworld.org/docid/4538838c22.html>>



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

Bibliografia

“Koment i përgjithshëm nr. 4 (2016), Neni 24: E drejta e arsimit inkluziv” – paragrafi 17 OKB Komiteti për të drejtat e personave me handicap, në dispozicion në: <<http://www.refworld.org/docid/57c977e34.html>>

“Koment i përgjithshëm nr. 4 (2016), Neni 24: E drejta e arsimit inkluziv” – paragrafi 11 OKB Komiteti për personat me handicap. Në dispozicion në: <<http://www.refworld.org/docid/4538838f0.html>>

Poposka Zh. Publikimi, “Interpretues i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Handikap i Organizatës të Kombeve të Bashkuara”, faqe 69-70, 2018 Polio Plus, Në dispozicion në: <<http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/Tolkuvac-B5-mk.pdf>>

Dr. Poposka Zh, Dr. Jovevski L. Publikimi: “E drejta antidiskriminuese”, OSBE në Shkup

Pikëpamjet përfundimtare të Raportit inicial të Republikës së Maqedonisë nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Handikap, të miratuara nga Komiteti në mbledhjen e 20-të (27 gusht-21 shtator 2018). OKB Komiteti për të Drejtat e Personave me Handikap. Në dispozicion në: <https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/MKD/CO/1&Lang=En>

Ligji i arsimit fillor, Tekst i konsoliduar, („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017), MASH, Në dispozicion në: <<http://www.mon.gov.mk/>>

Ligji i arsimit të mesëm, Tekst i konsoliduar, („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017), MASH, Në dispozicion në: <<http://www.mon.gov.mk/>>

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në arsim

Bibliografia

Ligji për arsimin e lartë, MASH, Në dispozicion në: <http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/ZAKON_VISOKOTO_OBRAZOVANIE-final.pdf>

Ligji i arsimit të lartë, MASH, Në dispozicion në: <<http://www.mon.gov.mk/>>

Indikatorët për cilësinë e punës së shkollave, MASH, Në dispozicion në: <http://mirceacev-lisicani.weebly.com/uploads/2/5/2/8/25280659/indikator.pdf>

Ligji i teksteve shkollore për arsim fillor dhe të mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 120/2013, 29/2014, 146/2015, 217/2015 dhe 30/2016)

Ligji për arsimtarët në shkollat fillore dhe të mesme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 10/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017)

Raport nga organizatat e personave me handicap dhe organizatave të qytetarëve për implementimin e KPLH, i dorëzuar për shqyrtim në sesionin e 20-të të OKB Komiteti mbi të drejtat e personave me handicap, viti 2018. Në dispozicion në: <https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=INT%2fCRPD%2fCSS%2fMKD%2f31979&Lang=en>

Ligji për standardet e nxënësve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 52/2005, 117/2008, 17/2011, 135/2011, 15/2013, 41/2014, 146/2015 dhe 30/2016)

Najçevska M., Kadriu B., Jandrijeska Jovanova K., Çavkovska B., Mora Bajrami V., Të padukshëm për shoqërinë, Vlerësim i gatishmërisë për ratifikimin e Konventës mbi të drejtat e personave me pengesa, Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni, Shkup, viti 2011. Në dispozicion në: <<http://soros.org.mk/dokumenti/FOOM-Nevodlivi-za-opstestvoto-MK.pdf>>

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 50/2010, i datës 13 prill 2010. Në dispozicion në: <<http://www.mtsp.gov.mk>> dhe <<http://www.slvesnik.com.mk>>.



HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

Bibliografia

Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2016/2017, Pasqyrë statistikore nr. 2.4.18.05/896, Enti Shtetëror i Statistikës, 2018. Në dispozicion në: < <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.05.pdf>

Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2012/2013 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.18.05/896, Enti Shtetëror i Statistikës, 2014. Në dispozicion në: < <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.05.pdf>>

Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2013/2014 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.15.07/816, Enti Shtetëror i Statistikës, 2015. Në dispozicion në:<<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.15.07.pdf>>

Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2014/2015 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.16.06/851, Enti Shtetëror i Statistikës, 2016. Në dispozicion në:< <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.16.06.pdf>>

Shkollat fillore dhe të mesme në fund të vitit 2015/2016 Pasqyrë statistikore nr. 2.4.17.05/874, Enti Shtetëror i Statistikës, 2017. Në dispozicion në:< <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.17.05.pdf> >

Mbrojtja sociale e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve, 2017, Pasqyrë statistikore nr. 2.4.18.10/901, Enti Shtetëror i Statistikës, 2018, Në dispozicion në:< <http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=22>>

Raport nga hulumtimi: Zbatimi i teknologjisë informatike asistive në shkollat e rregullta fillore në Maqedoni, nevojat dhe gjendja aktuale, Hapni dyert, Shkup, mars 2011, faqe 9-15.

Adrijana Isahi-Pallosi, Lidushka Vasilevska, Lepa Tërçeska, Goran Spasovski, Radmilla Stojkovska-Aleksova, David Crabtree, Inkluzioni në arsimin e mesëm profesional, doracak për punë me nxënësit me nevoja të posaçme, Këshilli Britanik, Shkup, viti 2014, faqe 69

HALLKA QË MUNGON

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në arsim

Bibliografia

Publikimi: Arsimi INKLUZIV në kuadër të shkollave sipas masës së nxënësve: rezultatet dhe rekomandimet nga studimi për Maqedoninë, MASH, viti 2010, Në dispozicion në: <[http://www.unicef.org/tfyrmaqedonia/INCLUSIVE_REPORT_MKD\(1\).pdf](http://www.unicef.org/tfyrmaqedonia/INCLUSIVE_REPORT_MKD(1).pdf)>

Raport: “Mapimi i VET praktikave dhe politikave arsimore për inkluzionin dhe kohezionin social në Ballkanin Perëndimor, Turqi dhe Izrael. Raporti për Maqedoninë” viti 2013, Në dispozicion në:<http://docplayer.net/79775693-Mapping-of-vet-educational-policies-and-practices-for-social-inclusion-and-social-cohesion-in-the-ëestern-balkans-turkey-and-israel.html>>

Zhaneta Poposka, Bekim Kadriu, Elena Grozdanova, Rexhepali Çupi, Elena Koçoska, Analiza e praktikave diskriminuese në sferën e arsimit, OSBE dhe MPPS, Shkup, viti 2014, faqe 103

Koçoska E., Shavreski Z., Jovanovska V., Llazovski V., Publikimi Analiza e gjendjes së personave me pengesa fizike në Republikën e Maqedonisë”, viti 2016, Komiteti i Helsinkit. Në dispozicion në:< http://ëëë.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/2545/_____5_.pdf >

Raport i Avokatit të Popullit: “Informacion për gjendjen e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të posaçme në shkollat speciale fillore dhe të mesme”, Avokati i Popullit 2013, Në dispozicion në:< <http://ombudsman.mk/upload/documents/2013/Izvestaj-Posebni%20ucilista-2014.pdf>>

Polio plus – lëvizja kundër handiklapit

Polio Plus është organizatë maqedonase multietnike, multikonfesionale qytetare e personave me dhe pa handikap e cila punon në lidhje esenciale dhe realizimit të plotë të së drejtave dhe lirive themelore të personave me handikap.

Misioni ynë është përforcimi i besueshmërisë të personave me handikap dhe krijimin e shoqërisë me mundësi të barabarta për të gjithë.

Misionin e realizojmë nëpërmjet përfaqësimit dhe lobimit për ndryshime dhe menaxhim të legjislacionit, arsimit, punësimit dhe jetës së pavarur të personave me handikap nga njëra anë, si dhe ngritjes së vetëdijes publike, afirmimit të kreativitetit të tyre dhe kontribut në bashkësi nga ana tjetër.

“Polio Plus nuk udhëton vetë”. Misionin tonë e realizojmë së bashku me faktorë tjerë të shoqërisë.

Kontakt

Polio Plus – lëvizje kundër handiklapit

Bulevar Avnoj 64 lokal 2

1000 Shkup, Maqedoni

Telefon/faks: +389 2 2400 544

E- posta: polioplus@polioplus.org.mk



MARGINA OBSCURA



Agency for Cooperation, Education and Development



Polio Plus

Lëvizje kundër handikapit